



D R I T A

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Korrik/Gusht 2008 • Viti XXV • Nr. 7/8 (166) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3SFR, SHBA \$2.50



QËLLIMET, VETITË DHE KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË KURORËS SË MARTESËS

FAQE 6-7

(Shkruan: DON JETON THAQI)



TË RINJTË – PROFETË TË EPOKËS SË RE ME FUQINË E SHPIRITIT SHENJTË

FAQE 11-12

(Shkruan: DON FATMIR KOLIQI)

PERËNDIMORJA NË MUZIKËN E ZEQRIRJA BALLATËS (I)

FAQE 18-19

(Shkruan: AKIL MARK KOCI)



■ KËNDVËSHTRIM

Pushimet verore – turizmi

■ SHKRUAN:

P. Shtjefën DODES, SJ

Shumë prej nesh kemi filluar ta nuhasin, disa edhe ta shijojnë, joshjen e të qenit të lirë dhe të mundësisë së përcaktimit të pavarur për fatin individual (shoqëror). Dëshirojmë të vendosim jo vetëm për të rojtur, mbijetuar, por edhe për të jetuar një jetë të denjë njerëzore, përparimtare, që na ofron njëri me tjetrin. Ajo që më parë dukej se ishte e pamundur, sot fillon të japë shenja jete dhe të vërehet, sepse nevojat dhe dëshirat tona po ndryshojnë. Vërtet, ajo ka qenë gjithmonë e pranishme, por vëmendja jonë e (sh)përqendruar në kahe dhe përmbajtje tjera e ka penguar perceptimin dhe mundësinë e shijimit të bukurive që na rrethojnë.

Njeriu si qenie e cila e ka mundësinë e perceptimit, arsyetimit dhe vendimit duhet të jetë gjithnjë e më i vetëdijshëm për nevojat e tija njerëzore. Njëra prej këtyre nevojave natyrore është pushimi, edhe ai veror (vjeter). Njeriu nuk guxon të jetojë vetëm në punë, të jetë prodhues. Ai është i thirrur të jetë njeri edhe në kohë të lirë, në lojë, në pushim. Koha e lirë nuk është (nuk do të duhej të ishte) humbje kohe. Pa Zotin edhe koha e lirë edhe pushimi e humbin vlerën. Pa Zotin, i cili e ka ftuar njeriun në veprim dhe pushim bashkëkrijimtar, as koha e lirë nuk ka kuptim, kurse Shkrimi Shenjtë qartë tërheq vëmendjen: “Kush nuk do të punojë, as mos të hajë!” (2 Sel 3,10).

Lodhja dhe humbja e fuqisë si duket është bërë një fenomen i përgjithshëm. Madje dëgjojmë edhe ankime për një lodhje permanente: lodhje pranverore, lodhje para pushimeve verore, por edhe pas tyre, lodhje vjeshtore; ekziston edhe lodhja dimërore. Për të krishterën koha e lirë është në njëfarë mënyre detyrë. Në të e përjetojmë realitetin tonë rreth vetes si të bukur. Për të qenë ajo që është, koha e lirë për të krishterën është e mbështetur në krenimin/falënderimin e Atij që është qendra e të mirës – Zotit. Kisha në parim e ka gjithmonë një qëndrim pozitiv ndaj kohës së lirë, pushimeve verore, turizmit, duke parë në to një realitet shoqëror. Këtyre fenomeneve i qaset në dritën e të vërtetave ungujllore që pjesëmarrësve të këtij realiteti të ri t’u ndihmojë t’i zbulojnë aspektet dhe mundësitë e reja pozitive.

Çdonjëri prej nesh e ndjen nevojën e zëvendësimit të kohës së punës me momentet e çlodhjes. Pas detyrave të rregullta në aktivitete të lira ripërtëritet shpirti dhe trupi. Sporti dhe ushtrimet fizike, udhëtimet dhe veprimtaritë kulturore, vizitat e familjeve apo miqve, pjesëmarrja në jetën e shoqërive të ndryshme bëhet pjesë përbërëse e jetës.

Për fat të keq për shumë kënd puna është bërë një lloj i ri i robërisë për shkak të kushteve të vështira në të cilat janë të detyruar të punojnë. Në vendet më të varfra të botës, por edhe në Kosovë për shkak të numrit të lartë të papunësisë, shumë vetë nuk mund ta realizojnë të drejtën e tyre për të punuar. Në këtë atmosferë problemi i papunësisë bëhet një problem i rënd dhe një e keqe e madhe. Puna si veti e përcakton cilësinë e brendësisë së njeriut dhe, në një kuptim të caktuar, e përbën vetë natyrën e tij. Nëse njeriu nuk punon, apo nëse nuk i është dhënë mundësia, nëse nuk i është njohur dhe siguruar e drejta e tij në punë, ekziston edhe rreziku shpirtëror i rënies në njëfarë hapësire “të kohës së lirë kolektive”, “pushimeve (të shumta) vjetore/verore”, që shpejt mund të shndërrohet në djerradite (përtaci). Për këtë arsye, bashkë me të vërtetën e dëmit ekonomik të një gjendje të tillë, shkon edhe ai kulturor: nuk është mirë kur njeriu ka tepër kohë të lirë, të —>



Katolicizmi në Prizren dhe rrethinë në shekuj

FAQE 14-15

Shkruan: Prof. dr. Jahja DRANÇOLLI

Intervista me Mark Krasniqin

Seminari katolik dhe gjimnazi real në Prizren – burime të edukimit e të mësimi (I)

FAQE 12-13



cilën nuk mund ta plotësojë. Për këtë arsye është e domosdoshme të gjendet masa e drejtë në mes kohës së lirë, dhe interpretimit të drejtë të kohës së lirë, pushimit në njërin dhe punës në anën tjetër.

Në vrapimin e pa ndalur të jetës së sotshme, sipas hulumtimeve të shumta, pushimi veror, apo turizmi, është kohë e çmuar pikërisht për kërkimin e kuptimit të jetës. Kërkimi i kuptimit nuk ndërpritet as në kohën që është e rezervuar për pushimin e njeriut. Në atë kohë njeriu e ka mundësinë të ikë prej të gjitha sendeve, por jo edhe prej vetvetes. Prandaj njeriu është i thirrur që pushimin e tij ta fillojë në zemrën e tij duke mbjellur paqen dhe gëzimin për ta rizbuluar kuptimin e kohës së lirë, takimin me zemrën e të afërmit, ngrohtësinë e diellit dhe një çik qiell në tokë që pret t'i dhurohet.

Turistë të shumë në pushimet e tyre vjetore vizitojnë vende natyrore dhe objekte të ndryshme sakrale, kulturore, që tregojnë synimin për një zgjerim të horizontit, për ngritje personale. Është interesante se mistikët, njerëzit e thellur në Zotin, afërsinë e Zotit në mënyrën më të thellë e kanë përjetuar nëpërmjet natyrës, të gjitha sendeve të krijuara. Natyra pra e zbulon Zotin. Njerëzit e kohës bashkëkohore me afsh e dëshirojnë natyrën e cila frymëzon pamatësinë, pakufizimin, ripërtërin mendjen dhe zemrën dhe vazhdimisht sjell freski.

Kosova si shtet i ri me një numër relativisht të vogël banorësh me bukuritë e saja të mëdha natyrore po bëhet gjithnjë e më joshës jo vetëm për banorët vendor, por edhe ata ndërkombëtar.



mbëtar. Zoti po i takon në thellësitë e ndërgjegjes me mijëra njerëz që e vizitojnë atë nëpër male, fusha, liqe e lumenj. Në këto bukuri po shkruhen historitë të shumta vizitorësh. Grupet malore që e rrethojnë Kosovën si Malet e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna, pastaj lumenjtë e ndryshëm si Drini i Bardhë, Sitnica, Ibri, Lepenci etj., liqe dhe male të larta si Gjeravica,

Bistra, Luboteni etj., janë vetëm disa mundësi që në këtë pasqyrë natyrore njeriu të mund ta njohë më mirë veten, më shumë të gëzohet duke i shijuar me falënderim të gjitha këto dhurata nga Zoti.

Para pak ditësh dëgjuam se miq jo kosovarë që ndihen si vendas, ndërmorën dhe publikuan një libër apo ciceron si udhëheqës shumë të qartë për

informatat e thjeshta se ku gjendet Kosova, klima e saj, vendet turistike, shtigjet e vrapimit, lumenjtë, kishat, xhamitë, traditën dhe historinë e deri të kuzhinat tradicionale që ofron Kosova. Edhe pse për bukuritë e Kosovës po tregohen më të shkathët dhe më të interesuar jovendorët, ia vlen me falënderim të shihet njohja e tyre e mirë e vendeve tona për ta njohur, çmuar dhe dashur edhe më shumë vetveten.

Pyetja e zhvillimit të Kosovës dhe e zotshetëpisë së mirë për mysafirët e ardhur duhet të jetë preokupim i të gjitha fuqive shpirtërore, intelektuale dhe krijuese të kombit shqiptar. Ajo do të duhej të ishte pyetja thelbësore e të përgjegjshmëve në shoqëri në të gjitha nivelet, jo aq për mysafirët sa për të mirën e vet banorëve shqiptarë dhe popullit të tij. Do të jemi zotshetëpie i mirë nëse shumica e qytetarëve tanë të jenë të formuar në identitetin, kulturën, humanitetin e tyre dhe çiltërinë e tyre për takimin me të tjerët dhe më të ndryshmit. Kjo do të thotë, kur të jemi të vetëdijshëm për vlerat vetjake, përparësitë dhe kufijtë e vetvetes.

Nëse e lëshojmë rastin që të zhvillohemi e të bëhemi zotshetëpie të vërtetë, na kanoset rreziku i madh që të shkrihemi në procese bashkëkohore globalizuese që mund t'i fshijnë si identitetet veç e veç po ashtu edhe popuj të tërë dhe kulturat e tyre kurse të

huaft do ta marrin fjalën kryesore, jo vetëm në një lëmi...

Lajmet ditore na paraqesin fotografi që tregojnë një njerëzim të lodhur dhe të ngarkuar. Sa herë shikojmë padrejtësi, luftëra, katastrofa, krimanlitete, skamje... Me popuj të tërë jetojnë në mërim: mungesa e ushqimit, kurrfarë sigurie, puna e rëndë, vuajtja... Mirëpo, edhe ata që materialisht janë mirë të siguruar mund të jenë, dhe shpesh edhe janë, të lodhur nga jeta. Komplexiteti i jetës në shoqëritë moderne shkaktojnë ngarkesa psikike, vuajtje të brendshme, pasiguri, pakuptim, sëmundje, frikë, mosmarrëveshje, vetmi. Asnjë njeri nuk është i privuar nga lodhja dhe ngarkesa. Për këtë arsye edhe Jezusi na thërrret të gjithëve pa dallim: "Ejani tek unë të gjithë ju që jeni të lodhur prej barrës së rëndë e unë do t'ju çlodh." Kjo shpresë se nuk jemi të lënë të vetmuar bëhet burim i fuqisë dhe optimizmit të jetës që na ruan nga dëshpërimi. Fjalët e Jezu Krishtit, por mbi të gjitha jeta e tij, na tregojnë vazhdimisht se si ta tejkalojmë lodhjen, ngarkesën, të keqen.

Puna dhe pushimi, përgjegjësia në rrugë - në ngasjen e veturës, dhe në çdo rrethanë tjetër të jetës e kanë një qëllim: ta humanizojnë njeriun të cilit i kanoset dehumanizimi dhe t'i kthehet ai dinjitet burimor me të cilin e ka pajisur Zoti me krijimin e tij - duke e krijuar edhe për punë edhe për pushim.



Qendra e parë në Kosovë për edukimin dhe detektimin e fëmijëve me nevoja të veçanta

Në vitin 2003 Caritas-i gjerman ndërtoi Çerdhen Integruese pranë objektit të Shkollës Speciale "Nënë Terezë" në Prizren, e cila iu ofron fëmijëve me nevoja të veçanta dhe prindërve të tyre shpresë të re në angazhimin e tyre të hershëm në sistemin arsimor nga moshë 3-6 vjeçare.

Duke iu referuar situatës aktuale në regionin e Prizrenit, fëmijët janë të përkujdesur që nga moshë 3-vjeçare dhe më lart, mirëpo ekziston një nevojë urgjente që të mbulohet periudha nga lindja e fëmijëve deri në moshën 3-vjeçare.

Qendra "Edukimi dhe detektimi i hershëm" filloi punën që nga muaji qershor 2008, që ndodhet në hapësirat e Qendrës Familjare nr. 1; i cili projekt financohet nga Caritas-i gjerman ndërsa implementohet nga Caritas-i i Kosovës – zyra rajonale Prizren, në bashkëpunim me Handikosin dhe institucionet përkatëse shëndetësore vendore.

Kjo qendër ofron mundësi më të mira për zhvillimin e hershëm të fëmijëve me nevoja të veçanta (0-4-vjeçare) si në: zhvillimin e

tyre mendor, fizik, shoqërore dhe emocional dhe u ofron ndihmë të veçante prindërve të fëmijëve. Sipas motos: "Ndihma e hershme – ndihma më e mirë".

Për fëmijën është e nevojshme të përkrahet intensivisht zhvillimi i hershëm, sepse aftësia për nxënie dhe perceptim është më e madhe në periudhën e parë të zhvillimit, të ndihmohet në mënyrë që të evitohet aftësinë e kufizuar që u kanoset. Procesi kryhet me anë të lodrave sepse vete loja është pjesë më e rëndësishme e jetës së fëmijës.

Këtë zhvillim të hershëm duhet ta ndjekin fëmijët që janë dëmtuar gjatë lindjes apo kanë pasur komplikime, shqisat i kanë të kufizuara, siç janë: të pamurit, të dëgjuarit, ndjeshmëria, të folurit; zhvillimi është i vonuar ose disi nuk është në akordim me zhvillimin normal; fëmija është shumë i qetë ose nervoz; ka mungesë koncentrimi, është pak këmbëngulës, kapaciteti për lojë nuk është i lëvizshëm, aftësia e kufizuar ndikon/prek zhvillimin e vet fëmijës etj.

Shumica e prindërve nuk dinë si të veprojnë me fëmijën e tyre



Strafi i punës në Qendër

të porsalindur me nevoja të veçanta dhe nuk u japin mundësi për integrimin e brendshëm brenda familjeve së tyre.

Qendra po ashtu u ofron prindërve përkrahje në lidhje me zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve, kurajë dhe ndihmë për pri-

ndërit, që të ndihmojnë vetveten, mësojnë të vështrojnë/dallojnë fuqinë individuale të fëmija, marrin informata të mjaftueshme rreth aftësisë së kufizuar, nevojave të veçanta, përkrahje rreth sistemit shkollor etj.

Përveç punës në qendër puna

më e rëndësishme, më efektive bëhet edhe nëpër familje, ku edukatorja speciale dhe infermierja vizitojnë familjet dhe u tregojnë/inkurajojnë prindërit si të veprohet me metoda adekuate për bashkëveprimin midis nënës dhe fëmijës. (Ida Delbysa)



Dy fëmijë të Qendrës

Të rinjtë e famullisë së Klinës gjatë vizitës në Shqipëri



Të rinjtë e Famullisë së Klinës në vizitë në Shqipëri

Të rinjtë të famullisë së Klinës na u dha një mundësi e jashtëzakonshme, falë atyre që e duan të mirën e të rinjve, ndihmës së shoqatës italiane RTM, ndihmës së famullisë dhe vetë kontributit të të rinjve, për ta vizituar vendin shumë të bukur

Shqipërinë. Udhëtimin tonë drejtë Shqipërisë e filluam ditën e hanë, në mëngjesin e 7 korrikut dhe përfunduam në fund të po asaj jave.

Nga shumë të rinj që ka famullia e jonë, u zgjodhën mbi 40-të sish, nga të gjitha fshatrat

e famullisë së Klinës. Të gjithë ishim të ngazëllyer për këtë udhëtim duke marrë parasysh edhe të kaluarën e mundimshme por edhe shumë të lavdishme që përjetoj pjesa e popullit tonë që jeton në Shqipëri. Gjatë udhëtimit së bashku me meshtarin

tonë, don Antonin, u ndalem dhe vizitua vende dhe Kisha të shumta.

Diku në mbremje arritëm në qytetin e Shkodrës, dhe shkuam te motrat françeskane në Hot të Ri tek të cilat do të qëndronim gjatë atyre ditëve. Mirëprirja, da-

shuria dhe ngrohtësia e motrave në bënë që ta përjetojmë edhe më mirë një përvojë të tillë, për çka edhe i falënderojmë shumë.

Gjatë këtyre ditëve vizituam shumë qytete si, p.sh Shkodrën, Lezhën, Krujën, Tiranën, Durrësin, Laçin, Rrëshenin... si dhe shume monumente, manastire dhe Kisha të ndryshme, dhe takuam shumë njerëz të cilët na folën dhe na shpjeguan gjëra shumë të rëndësishme të historisë së Kishës në Shqipëri dhe të popullit tonë.

Në të gjitha ditët e qëndrimit tonë kishim momente të ndryshme të lutjes, mundësinë për një bisedë shpirtërore me meshtarin, mundësinë e rrëfimit dhe Meshën shenjte, që ishte një mundësi shumë e mirë për ta kuptuar planin e Zotit në jetën tonë dhe dashurinë e Tij për ne dhe për t'u afruar më shumë kah Ai. Gjitha këto aktivitete të larmishme u bënë shkas i një njohje më të thellë dhe më të mirë me njëri tjetrin dhe me historinë e lavdishme të vendeve të bukura që vizituam.

Qëndrimi ynë në Shqipëri do të mbetet një përvojë e paharruar për të gjithë, do të mbetet në kujtesën e secilit të ri si një nga përvojat më të bukura, për çka edhe falënderojmë nga zemra ata që menduan dhe e realizuan një gjë të tillë për formimin, për rritjen dhe për bashkimin tonë me njëri tjetrin. (Arta Musolli)



Në vizitë te varri i Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti në Lezhë

Jubileu i 40-të i enciklikës “*Humanae Vitae*”, e Papës Pali VI



Më 25 korrik janë mbushur 40 vjet, ç'prej se Papa Pali VI ka publikuar letren enciklike “*Humanae Vitae*” (shq. *Jeta njerëzore*) – mbi rregullimin e drejtë të lindjes.

Lexusit e Dritës kanë pasur rastin në numrin e kaluar (*Drita, qershor 2008, f. 10-11*) të lexojnë për këtë papë të madh me rastin e 30-vjetorit të vdekjes. Pa dyshim se Pali VI ka shënuar një epokë në jetën e Kishës në shekullin e kaluar, një epokë që do të mbetet e shënuar, për vetë faktin se ai që një personalitet i fesë dhe guximit, dhe, si i tillë, pontifikati i tij do të mbetet i paharruar. Si papë i koncilii II të Vatikanit, e

çoi Koncilin në përfundim. Pas Koncilii krijoi mekanizma të efektshëm për zbatimin e dekreteve dhe kushtetutave konciliane.

Pali VI është i njohur edhe për enciklikat e veta të dalluara, prej të cilave “*Humanae Vitae*” spikatet dukshëm.

“*Është detyrë e vështirë për ta bartur jetën njerëzore, në të cilën bashkëbortët janë bashkëpunëtorë të lirë e të përgjegjshëm të Hyjit Krijues. Kjo detyrë ka qenë gjithnjë burim gëzimi, ndonëse nuk kanë mundur kurrë as ankthi e vështirësitë...*”. Janë këto fjalët me të cilët nis enciklika në fjalë, e cila në përmbajtjen e saj jep parimet

morale të dashurisë bashkëshortore, gjithnjë duke pasur parasysh tërësinë e njeriut, dinjitetin e tij si shëmbëllesë e Hyjit dhe përgjegjësinë e Kishës për t'u kujdesur për të si Nënë e njerëzimit. Ati i Shenjtë ka spikatur mbi të gjitha me guximin prej Bariu, për të nënvizuar se akti seksual, marrëdhëniet martesore, përgjegjësia atërore e amnore do mbesin akte të larta e të dinjitetshme, përkundrazi zhvillimit teknologjik dhe inxheneringut gjenetik dhe spektakleve diskriminuese të liberalizmit të tepruar shoqëror. Edhe Benedikti XVI, kohët e fundit, në Univer-

sitetin e Lateranit, ka bërë një refleksion të thellë duke e quajtur enciklikën *fryt i një vendimi të thellë, gjet gjësimtar në përpjekjen për të ripohuar vazhdimësinë e doktrinës dhe traditës së Kishës*. Ky është një mësim jo i lehtë për t'u proklamuar – ka nënvizuar Ati i Shenjtë.

Enciklika ka 3 kapituj, me hyrje të shkurtër ku tregohet arsyeja e domosdoshmërisë për të reflektuar për çështjet e dashurisë dhe lindjes. Në fund të enciklikës kemi një *Apel* për ipeshkvijtë e tërë botës dhe njerëzve vullnetmirë që të ndihmojnë në respektimin e ligjit natyror dhe Hyjnor.

Përmes tre kapitujve jo të gjatë, Pali VI ka paraqitur qëndrimin e Kishës për çështjet e dashurisë bashkëshortore ndërmjet burrit dhe gruas, duke nënvizuar se kjo marrëdhënie vazhdon të jetë pjesëmarrëse në veprën krijuese të Hyjit. Në mënyrë të veçantë Ati i Shenjtë ka tërhequr vëmendjen botës e njerëzimit që personi i njeriut dhe krijimi i jetës të shi-

kohet sipas “*parimit të tërësisë*” – , sepse njeriu nuk mund të jetë produkt i teknikave dhe mjeteve, por fryt i dashurisë mes burrit dhe gruas që i dhurohen njëri tjetrit tërësisht dhe pa kushtëzime. Ky mister mahnitës i bartjes së jetës, ngërthen në vetvete respektin, li-

“ Në mënyrë të veçantë Ati i Shenjtë, në enciklikë, ka tërhequr vëmendjen botës e njerëzimit që personi i njeriut dhe krijimi i jetës të shikohet sipas “*parimit të tërësisë*” – , sepse njeriu nuk mund të jetë produkt i teknikave dhe mjeteve, por fryt i dashurisë mes burrit dhe gruas që i dhurohen njëri tjetrit tërësisht dhe pa kushtëzime. Ky mister mahnitës i bartjes së jetës, ngërthen në vetvete respektin, lirinë, përgjegjësinë pa e tjetërsuar intimitetin njerëzor, por duke e përbrendësuar në vetvete si dhuratë të Hyjit. ”

rinë, përgjegjësinë pa e tjetërsuar intimitetin njerëzor, por duke e përbrendësuar në vetvete si dhuratë të Hyjit. Duke u nisur nga ky parim, ky vizion i dashurisë dhe seksit martesor, Pali VI në enciklikë dënon të gjitha mjetet që dëmtojnë, ndërpresin, ndalojnë apo vrasin procesin natyror të krijimit të jetës së re. Kështu mjetet kontraceptive, sterilizimi i pjesshëm apo i plotë, e shumë të tjera të ngjashme, janë të papranueshme për Doktrinën e shenjtë që vetë Jezu Krishti ia ka besuar Kishës.

Vendosmëria e Palit VI për këto pika, që edhe sot janë aktuale, ka nxitur në atë kohë një reagim të gjithanshëm të atyre që proklamnin liberalizim të papërgjegjshëm të seksualitetit. Fatkeqësisht, reagime dhe mos pajtimit për përmbajtjen e letres enciklike ka pasur edhe përbrenda kishës, posaçërisht në botën gjermane. Enciklika *Humanae Vitae* ka pësuar që në dalje një grusht të rëndë, porse lënda e saj që atëherë nuk pushon të mbetet aktuale,

nxitëse, dhe, padyshim, si dokument kishar është treguar shumë largpamës. Duke marrë guximin të thotë fjalë të vështira, na kujton të vërtetën dhe dinjitetin e njeriut, të jetës e të dashurisë, që tepër shpesh bie në harresë. E, si pasojë, njeriu nuk bëhet aspak më

i lumtur, përkundrazi, “mbyllet në rrethin e egoizmit mbyës që rri gjithnjë në pritë”. Ndërsa “dashuria dhe arsyeja së bashku mund të bëjnë diçka shumë të madhe”: Po: duhet shpëtuat dashuria, për të sotmen e për të nesërmen. Për të gjithë! – nënvizoi Benedikti XV në Lateran.

Reflektime për enciklikën *Humanae Vitae* kanë dhënë edhe specialistët e fushave gjenetike, gjinekologjike në botën italiane. Maria Luisa Di Pietro, profesoreshë e bioetikës në Universitetin Romak Katolik dhe kryetare e shoqatës “Shkenca dhe jeta”, thotë se në kohën kur enciklika është botuar, pakkush ka ngritur zërin për politikën e mbikëqyrjes demografike, për banalizimin e seksualitetit, kurse Pali VI në këtë enciklikë na ofron përmbajtje të ngjeshur mbi to dhe na nxit të përsiasim e të reflektojmë. Prof. Di Pietro vazhdon ta quajë enciklikën si *porosi të shpresës së madhe*, ftesë për ta respektuar tiparet e jetës dhe dinjitetin e saj. Si e këtillë enciklika është një pasuri shumë e madhe që na e ka dhuruar Pali VI.

Gian Maria Vian, nga L'Osservatore Romano, e ka cilësuar enciklikën si *dokument profetik* për sa i përket progresit të inxhineritit frikësues gjenetik, që sot është në kulmin e vet. (*Don Fatmir Koliqi*)

Papa priti në Kastel Gandolfo kryeministrin irakian, al-Maliki

Dënim i përbashkët i terrorizmit

Në Pallatin Apostolik në Kastel Gandolfo, Benedikti XVI priti në audiencë Nuri Kamel al-Maliki, kryeministër i Republikës së Irakut. Papa dhe kryeministri irakian dënuan bashkërisht terrorizmin. Më pas ripohuan vlerën e madhe të dialogut ndërfetar, duke e parë si rrugë për mirëkuptimin fetar e për bashkëjetesën civile. Kryeministri, i cili dje zbriti në Kriptën e Vatikanit për të nderuar kujtimin e Gjon Palit II, e ftoi Papën të vizitojë Irakun. Para takimit me Benediktin XVI, kryeministri Maliki vizitoi edhe sekretarin e Shtetit të Vatikanit, kardinalin Tarcizio Bertone, që shoqërohej nga Sekretari i Vatikanit për marrëdhëniet me shtetet, imzot Dominik Mamberti. Bisedimet – saktëson një notë e Sallës së

Shtypit të Vatikanit – u zhvilluan në një atmosferë të përzemërt, u përqendruan tek disa aspekte themelore të situatës irakiane, duke pasur parasysh edhe kontekstin zonal. Vëmendje e posaçme iu kushtua temës së refugjatëve të shumtë irakianë, brenda e jashtë vendit, që kanë nevojë për asistencë edhe në rast se krijohen kushte për t'u rikthyer në atdhe, gjë që urohet të ndodhë sa më shpejt. U dënuua përsëri dhuna e cila pothuajse çdo ditë trondit pjesë të ndryshme të vendit, pa kursyer bashkësitë e krishtera, që e ndjejnë më shumë se kurrë nevojën për të qenë më të sigurt. E kjo, sepse vitet e fundit bashkësia e krishterë po i nënshtrohet gjithnjë më shumë persekutimit, gjë që e dëshmojnë disa ngjarje tragjike. Kuj-

tojmë se më 3 qershor 2007, në Mosul, u vranë familletari i Kishës së Shpirtit Shenjt, atë Regat Ganni me tre diakonë; në shkurt 2008 u rrëmbye dhe u vra imzot Paulos Farai Rahho, kryepeshkvi kalde i Mosulit. Është derdhur pra, gjak, por nuk kanë munguar as shqetësime të tjera, që nuk pasqyrohen nga mediat, si sulmi kundër kryepeshkvisë së Mosulit në dhjetor të vitit 2004; bombat kundër kishave në vitet e mëpasme; rrëmbimi në janar 2005 i ipeshkvit siro-katolik të Mosulit, imzot Gjorgj Kasmusa e i shumë të krishterëve irakianë. Qindra mijëra njerëz detyrohen të braktisin vendin, për shkak të dhunës së vazhdueshme e të krizës së thellë ekonomike. Megjithatë, në një skenë kaq dramatike, nuk mungojnë as shenjat e shpresës. Gjatë takimit

të sotëm, të dyja palët uruan që Iraku të gjejë vendosmërisht rrugën e paqes e të zhvillimit, përmes dialogut e bashkëpunimit të të gjithë grupeve dhe etnive fetare, përfshirë edhe pakicat të cilat, duke respektuar identitetet përkatëse, me frymën e pajtimit e të kërkimit të së mirës së përbashkët, duhet të punojnë së bashku për rindërtimin moral e civil të vendit. U ripohua me forcë edhe rëndësia e dialogut ndërfetar, si rrugë për mirëkuptimin fetar e bashkëjetesën qytetare. Pas përfundimit të takimit, Benedikti XVI e Al-Maliki shkëmbyen dhuratat tradicionale: Papa mori si dhuratë nga mysafiri i largët, një palmë argjendi, ndërsa dhuroi një penë përkujtimore, realizuar me rastin e 500-vjetorit të Bazilikës së Shën Pjetrit. (*Radio Vatikan*)

Qëllimet, vetitë dhe karakteristikat kryesore të Kurorës së Martesës

■ SHKRUAN:
Don Jeton THAQI

Nga e drejta kanonore (kishtare)

Martesa është një kontratë bilaterale, me të cilën kontraktuesit, burri dhe gruaja, japin njëri-tjetrit dhe pranojnë reciprokisht të drejtën e përgjithmonshme dhe ekskluzive për trupin e vet, më qëllim të lindjes dhe të edukimit të fëmijëve (e drejta kanonore: *Can 1081 §2*). Por është një kontratë që dallon nga kontratat tjera, sepse e ka burimin hyjnor, dhe i rrënjësuar në vetë të drejtën natyrore dhe për arsye të konsensusit (marrëveshjes apo pëlqimit) nuk mund të mohohet nga asnjë autoritet njerëzor, për shkak të përmbajtjes dhe vetive esenciale të saj, që njëherësh iu nënshtrihen vullnetit të lirë të kontraktuesve (*CAN 1081 §1*). Në martesë, përveç numrit dhe gjinisë të kontraktuesve, kemi edhe përcaktimin apo determinimin e qëllimit (*il fine*) që është unioni fizik dhe koha e kontratës që duhet të zgjasë deri në mbarimin e jetës e njërit prej bashkëshortëve. Martesa pra, është e nevojshme dhe dobishme për gjithë racën njerëzore. Kështu, asnjë ligj njerëzor nuk mund ta kundërshtojë të drejtën që e ka vendosur vet Hyji: "rrituni dhe shumohuni..." (*Zan 1, 28*). Qëllimet kryesore të martesës janë dy: lindja, edukimi i fëmijëve dhe qëllimi i dytë është ndihma reciproke dhe përsosmëria e bashkëshortëve. Vetitë esenciale të martesës janë: bashkimi dhe pandashmëria, dhe kjo qysh prej origjinës (*Zan 2, 24, 1Cor 6, 16: Ef 5, 28*). Me qenë se i përkasin të drejtës natyrore, këto dy veti i obligojnë të gjithë pa dallim. Bashkimit të plotë i kundërshton poliandria (një grua merr shumë burra), ose poligamia apo poliginia (një burrë merr shumë gra). Dhe pandashmërisë i kundërshton ndarja-divorci. Me qëllimin primar dhe me vetitë esenciale qëndrojnë me një lidhje të ngushtë edhe të mirat e martesës: "bonum prolis" (e mira e lindjes dhe edukimit të

fëmijëve), "bonus fidei" (e mira e fesë) dhe "bonus sacramenti" (e mira e sakramentit). Origjina e fjalës martesë (italisht: *matrimonio*) rrjedh prej fjalëve latine *munus*: dhuratë, ngarkesë, detyrë, zyre pune dhe nga fjala tjetër *matris* (it. *della Madre*): i/e nanës. Por kuptimi i kësaj fjale do të ishte ky: është dhuratë, nder por edhe detyrë dhe obligim për të dy bashkëshortët. Ndërsa domethënia e fjalës sakrament është: shenjë e dukshme e një realiteti të padukshëm dhe shpirtëror.

Pjesa biblike

Dy tregimet e krijimit, ai Jahvist (*Zan 2*) dhe ai Priftorë (*Zan 1*) përfundojnë më një skenë që e themelon institucionin e martesës. Botëkuptimi i martesës dhe i ekzistencës së saj, në

Besëlidhjen e re, ekziston nga vet fakti i jetës së Jezusit, i cili lind prej një gruaje (*Gal 4,4; kbs/ Lk 11, 27*). Kështu që Jezu Krishti me jetën e vet e shenjtëron familjen, gjë që ka qenë e përgatitur nga e tërë Besëlidhja e Vjetër. Në Besëlidhjen e Re Jezu Krishti e tejkalon ligjin e Moisiut dhe pohon karakterin absolut të martesës dhe pazgjidhshmërinë e saj (*Mt 19, 1-9*). Duke e përjashtuar rastin e "kurvërimit" (khs. *Mt 19, 9*) që nuk synon ndoshta një justifikim të shkurozimit, por lidhet me përzënieën e një bashkëshorte të paligjshme ose me një ndarje, pas të cilës nuk mund të martohet më. Kënde buron edhe tmerr i dishepujve, para rreptsisë së ligjit të ri: "në qoftë se kjo është gjendja e burrit përballë gruas, më mirë të mos martohesh!" (*Mt 19, 10*).

Martesa para se gjithash është realitet njerëzor

Burri dhe gruaja janë të krijuar që të hyjnë në relacion në mes tyre, që reciprokisht ta pranojnë njëri-tjetrit, t'i dhurohen njëri-tjetrit, dhe me fjalë të tjera ta duan njëri-tjetrit. Dashuria dhe nevoja për t'u relacionuar, është e thadruar në qenien dhe natyrën e tyre; kështu që përvoja e dashurisë ndërmjet burrit dhe gruas është përvojë që më se shumti e karakterizon qenien njerëzore. Është fakt i pashmangshëm dhe i paevitueshëm që burri dhe gruaja nuk janë të krijuar për vetmi, por që të jetojnë në relacion dhe dashuri. Që e gjithë kjo i përket realitetit njerëzor, e dëshmon edhe fakti se martesa është e pranishme në çdo popull dhe kulturë, edhe pse në forma dhe mënyra të ndry-

shme. Në përgjithësi, vendimi për t'u lidhur më dikë për tërë jetën, ka marrë përsipër edhe karakterin publik: diçka që nuk ka të bëjë vetëm me sferën private, por që ndikon thellë edhe në jetën shoqërore e sidomos në transmetimin e jetës. Tiparet e besnikërisë dhe të definimit, janë kërkesa dhe nevoja të brendshme të dashurisë, si p.sh: "të dua përgjithmonë!" është shprehje e zakonshme që lind nga zemra e dy të dashuruarve qysh prej filimit të "aventurës" së tyre. Dhe nga kjo shprehje perceptojmë lehtë që ta duash një person, do të thotë ta duash në tërësi, në totalitetin e tij, për atë që është, për të kaluarën dhe për të ardhmen. Me fjalë të tjera është sikur të thuash se pandashmëria, para se të jetë thjeshtë një rregull, është një nevojë dhe karakteristikë e pat-



Nga ceremonia e kurorëzimit në katedralen e Prizrenit - 2008

jetësueshme e çfarëdo dashurie që dëshiron të jetë e vërtetë apo autentike.

Martesa është një realitet religjioz (fetar)

Duke lënë anash botëkuptimin e krishterë të martesës, e vërejmë qartazi që martesa është një realitet njerëzor shumë pozitiv dhe e pasur me domethënie: ajo realizon në burrin dhe gruan një relacion, madje, lumturinë dhe mirëqenien shpirtërore e materiale. Në jetën e të dashuruarve përgjithësisht, në mënyrë spon-tane, kjo situatë nënkuptohet (perceptohet) me kategorinë e misterit. Në fushën e religjio-neve, si zakonisht, një relacion dashurie vishet me dimensionin sakral. Edhe në Bibël e gjejmë një ndihmë në këtë aspekt dhe në aspektet tjera fundamentale të jetës njerëzore. Bibla na tregon që njeriu realizohet në relacion, që do të thotë, në dhurimin e vetvetes tjetrit, dhe pikërisht në këtë qëndron përngjasimi me i madh Hyjit (Zan 1, 26-27). Dashuria njerëzore i ka rrënjët më të thella në Zotin, vjen prej Zotit dhe në një mënyrë e zbulon Zotin. Kur një burrë dhe një grua duan dhe dashurojnë njëri-tjetrin, vërtet dhe sinjerisht, ata janë reflektim i Zotit, ata janë "sakrament natyror" i Zotit edhe nëse nuk janë të vetëdijshëm, apo nuk besojnë në Zotin. Këtë më fjalë të tjera e konfirmim edhe vetë shën Gjoni në letrën e tij: "Hyji është Dashuri dhe kush mbetet në Hyjin dhe Hyji mbetet në të" (1 Gjn 4,16). Por në përgjithësi e tërë Bibla është e shënuar nga një dashuri dhëndrore, aq e vërtetë sa që edhe vet raporti ndërmjet Hyjit dhe popullit të tij është i përshkruar me konotacione ndërmjet dhëndrit dhe nuses. Kjo temë është shumë e preferuar sidomos nga profetët si Ozeja dhe Isaia (Oz 2, 16-17. 20- 22; Is 62, 5). Ekziston edhe një libër që i kushtohet tërësisht dashurisë njerëzore: është Kënga e Këngëve, që do të thotë kënga më e mirë e këngëve. Duket që në këtë libër Zoti nuk theksohet kurrë, dhe në qendër të këngës qëndron dashuria njerëzore, megjithatë është pranuar ndër librat e Biblës që edhe njëherësh është fjala e Zotit. Nga kjo thjeshtë mund të nxjerrim, që në një mënyrë përvija e dashurisë njerëzore, kur kemi të bëjmë me një dashuri të vërtetë dhe të sinqertë, ajo është një përvija që aftron tek Hyji dhe mund të jetë dhe një zbulim i dashurisë së Tij. Prandaj nuk ekziston nevoja për bekimin apo që një rit i shenjtë ta bëjë më të mirë martesën, sikur që riti të bëjë përmirësimin e asaj që më parë nuk ishte. Edhe vetë dashuria e jetësuar vërtet, duhet të ketë karakteristika e unitetit (bashkimit), të besnikërisë (dashuria duhet të jetë ekskluzive dhe e pandashme)

dhe fekonditetit (frytshmërisë apo lindjes së fëmijëve). Të gjitha këtotribute më një mënyrë janë ato që i atribuohen martesës së krishterë. Mirëpo, meqenëse martesa, bashkimi i një burrë-grua, në vetvete është një realitet i mirë, ka domethënie të thella njerëzore dhe fetare, çka i shton fakti që ky rit të bëhet në Kishë? Cila është specifika e martesës së krishterë?

Martesa, për të krishterët, bëhet një sakrament

Martesa për të krishterët është një sakrament: një realitet njerëzor të marrë nga Jezu Krishti dhe të transformuar në domethënie më të thellë. Ky sakrament i vë themelet, rrënjët e veta në një relacion dashurie "natyrore" që zhvillohet dhe rritet brenda për brenda çiftit martesor: është pra kjo lidhje, ky relacion që e krijon materien e parë me të cilën ndërtohet ky sakrament, vend i takimi me Zotin dhe vend ku Hyji manifestohet. Është pra kjo lidhje, ky relacion me të gjitha

Krishti identifikohet me të dy, i thirrur të duaj tjetrin me dashurinë me të madhe; gjithashtu edhe Kisha identifikohet me të dy, sepse është e thirrur të rritet në dashuri. Këtë na e shpjegon shumë qartë edhe Familiaris Consortio: "Bashkimi ndërmjet Zotit dhe njeriut e gjen plotësimin definitiv në Jezu Krishtin, Dhëndrin, që dashuron dhe dhurohet si Shpëtimtar i njerëzimit duke e bashkuar atë me vetveten si trup të vetin... Ky zbulim e arrin plotësimin definitiv në dhurimin e dashurisë që Fjala e Hyjit, ia bënë njerëzimit duke e marrë natyrën njerëzore dhe në Flinë (sakrificën) që Jezu Krishti e realizon mbi kryq për Kishën, nusen e vet. Në këtë sakrificë zbulohet plani i përber-shëm që Zoti e kishte menduar në jetën e burrit dhe gruas qysh prej krijimit; martesa e të pagëzuar-ve bëhet menjëherë simbol real i Besëlidhjes së Re dhe të amshuar, të vulltosur me gjakun e Krishtit" (FC, nr. 13). Prandaj të martuarit e krishterë janë të thirrur vazhdimisht të bëjnë të pranishme

të flasë dhe t'i zbulohet botës. Të kremtosh martesën në Kishë, do të thotë të realizosh dhe të jetosh një ngjarje që e transformon një martesë në një sakrament. Por e gjithë kjo është e mundur duke iu falënderuar intervenimit të Jezu KRISHTIT: si të gjithë sakramentet edhe martesa është dhuratë e Jezusit, një manifestim i dashurisë së tij, që e bashkon një burrë me një grua, i mbron me ndihmën e vet dhe i bënë të aftë ta duan njëri-tjetrin me të njëjtën dashuri që Zoti na do ne. Prandaj është vet Jezu Krishti që lejon dhe mundëson çiftit dhe dashurisë se tyre reciproke të bëhet sakrament. Megjithatë çifti nuk është një sakrament pasiv, por përkundrazi është aktiv qysh prej kremtimit të ritit dhe zgjat deri në mbarimin e jetës. Është pikërisht historia e këtij raporti, e kësaj lidhje, që transformohet në historinë e shëlbimit, në "Bibël të gjallë". Me kremtimin e ritit, martesa bëhet po sakrament, por sakramenti bëhet i gjallë dhe i frytshëm, kur çifti e jeton

social. Sot kemi një ndryshim të mahnitshëm e sidomos në zhvillimin gjigantesk të teknologjisë e cila e ka ndryshuar edhe mënyrë e komunikimit dhe të raporteve në mes të njerëzve. Kështu që edhe për familjen dhe për çiftet bashkëshortorë, ekzistojnë vështirësi serioze dhe politika jo të favorshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndoshtë të familjes. Prandaj çfarë dëshiroj të theksoj? Dua të shpreh vështirësitë reale, në epokën tonë të ashtuquajtur postmoderne, për të jetuar apo jetësuar sakramentin e kurores së martesës. Për të jetuar vërtet jetën bashkëshortore me të gjitha tiparet, vetitë dhe karakteristikat e saj që janë, ndër të tjera, karakteristika dhe veti të ungjillit, të lajmit të gëzueshëm që Jezu Krishti e ka sjellë në botë. Prandaj të gjitha institucionet duke filluar nga familja, shkolla, kisha dhe të gjitha institucionet që kanë përgjegjësinë e edukimit, duhet të merren shumë seriozisht dhe të përgatisin gjenerata që vërtet

“Çka shënon, apo çka simbolizon martesa e dy të krishterëve? Lidhja apo raporti i dashurisë ndërmjet çiftit martesor të krishterë është shenjë efikase e dashurisë që ekziston ndërmjet Krishtit dhe Kishës: një dashuri bamirësie, krejtësisht falas, pa kurrfarë interesi, që arrin deri në ekstremim e fundit (e sakrifikoje jetën për të); një dashuri që nuk kushtëzohet apo nuk ndikohet prej përgjigjeve (Krishti e do Kishën edhe kur ajo është nuse jo besnike); një dashuri që e transformon njeriun duke e rimëkëmbur prej varfërisë së tij e duke e thirrur gjithnjë në një përgjigje dashurie.”

arritjet, sukseset e veta dhe me të gjitha vështirësitë që e bënë këtë sakrament. Në Shkrimin Shenjt nuk ekziston asnjë tekst, i cili na tregon qartë themelimin e sakramentit të martesës, por ekziston një tekst i ngjashëm që na flet se si bashkësitë e para jepnin vlerën sakramentore të martesës bashkimit të dy besimtarëve të gjinisë së kundërt (Ef 5, 25-28, 31-32).

Çka shënon, apo çka simbolizon martesa e dy të krishterëve? Lidhja apo raporti i dashurisë ndërmjet çiftit martesor të krishterë është shenjë efikase e dashurisë që ekziston ndërmjet Krishtit dhe Kishës: një dashuri bamirësie, krejtësisht falas, pa kurrfarë interesi, që arrin deri në ekstremim e fundit (e sakrifikoje jetën për të); një dashuri që nuk kushtëzohet apo nuk ndikohet prej përgjigjeve (Krishti e do kishën edhe kur ajo është nuse jo besnike); një dashuri që e transformon njeriun duke e rimëkëmbur prej varfërisë së tij e duke e thirrur gjithnjë në një përgjigje dashurie. Natyrisht që nuk duhet të bëhet identifikimi i Krishtit-burri dhe Kisha=gruaja!

lidhjen e Jezu Krishtit me botën, me njerëzimin, me Kishën. Historia e dashurisë e një çifti të krishterë bëhet gati një paradigmë e historisë së shpëtimit që Krishti e ka lidhë me Kishën në kohë.

Në këtë mënyrë sakramenti i martesës nuk jepet vetëm për çiftin dhe për të mirën e tyre, por i dhurohet bashkësisë, me pranimin (consensus) e lirë të të dyve: ata janë të thirrur në një shërbim, shërbesë të posaçme në bashkësinë e krishterë, në mes të shoqërisë. "Familja e merr misionin që të ruajë, të zbulojë dhe të komunikojë dashurinë, e cila është reflektim i dashurisë dhe pjesëmarrje reale e dashurisë së Zotit për njerëzimin dhe të Krishtit Zot për Kishën" (FC 17). Në të njëjtën kohë ky sakrament jepet edhe për shpëtimin e të martuarve: duke u përpjekur të duan njëri-tjetrin sikur Krishti e ka dashur Kishën, ata mundohen ta imitojnë dhe t'i përngjajnë Krishtit Shëlbues. Pra, me fjalë të tjera të deklarosh që martesa tek të krishterët është një sakrament, do të thotë që Zoti ka vendosur që nëpërmjet çiftit

martesën e vet në këtë dimension sakramental. Sakramenti i martesës nuk është diçka që merret një herë e përgjithmonë, por është diçka që jetohej. Çifti nuk ka, nuk posedon një sakrament, por bëhet sakrament me tërë jetën e vet. Prandaj të marthohesh do të thotë për të krishterët të marthohesh me Krishtin e jo vetëm një rit i thjeshtë e simpatik në Kishë.

Martesa dhe transformimet e mëdha socio-kulturore

Në familjet tona, në famullitë, në predikimet dhe fjalimet e meshtarëve dhe në bisedat e përgjithshme të besimtarëve tanë, edhe me siguri supozoj edhe tek vëllezërit tanë shqiptarë të fesë islame, gjithnjë e më tepër rritet brengosja dhe preokupimi i mbarëvajtjes familjare. Është vërtet një brengosje e thellë se si gjeneratat e ardhme do të dinë të krijojnë familje të shëndosha dhe të qëndrueshme. Vështirësitë më të mëdha duken, kur merren parasysh transformimet dhe ndryshimet e mëdha në nivelin kulturor, ekonomik, politik dhe

dëshirojnë ta ndërtojnë shoqërinë tonë duke e bazuar në familje. Pra, bashkëshortet e ri, familjet e reja në përgjithësi lypset të "armatosen" mirë dhe drejtë për t'i bërë ballë sfidave të reja që i sjellë koha. Lypset të jenë të vetëdijshëm për përgjithësitë dhe detyrat e veta dhe ta marrin me shumë seriozitet. Këtë e them, sepse vendimi i martesës ka të bëjë me tërë jetën individit. Por si shkak dhe arsye e këtyre vështirësive, përveç transformimeve të ndryshme që i përmendëm gjetiu, ekziston një sëmundje jashtëzakonisht degraduese për shoqërinë njerëzore, dhe ajo është zbehja dhe humbja e vullnetit dhe e dëshirës për t'u sakrifikuar për ideale të mëdha, siç është dashuria e vërtetë dhe sinqertë, besnikëria, familja e shëndoshe...! Të duash vërtet, të ngritësh familje të shëndoshtë, të jesh tërë jetën besnik-e, të edukosh dhe të formosh, kërkohet shumë munda, shumë dërsë, shumë sakrifica dhe flijime. E për këtë ka nevojë edhe shoqëria e jonë shqiptare, kisha jonë katolike dhe familjet tona.

Etërit e Kishës

Gjon Gojarti (344–404)

■ SHKRUAN:
Don Marjan DEMAJ

Gjoni u lind në Antioki, në një familje të pasur fisnore, rreth vitit 344. Babai i tij quhej Secund dhe nëna Antuza. Secundi ishte oficer i lartë dhe vdes i ri, ndërsa nëna e merr tërë barin për rritjen dhe edukimin e Gjoni dhe motrës së tij që ishte më e madhe. Gjoni pagëzohet në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare dhe studion retorikën dhe filozofinë.

Në fillim ishte në shërbim të shtetit, por nuk e gjeti veten aty. Së shpejti u largua dhe hyri në kuvend në Diadorë. Ndërkohë i vdes edhe nëna. Ai këtu në kuvend jeton gjashtë vite të rrepta asketike. Ishte i sëmure nga lukthi dhe kjo sëmundje e shoqëroi tërë jetën. Pikërisht kjo sëmundje bëri që të dalë prej rregulltarisë dhe të kthehet në Antioki.

Në vitin 381, ipeshkvi i Antiokisë e shuguron për diakon dhe pesë vite më vonë për meshtar. Gjoni merr detyrën e predikatarit në të gjitha kishat në Antioki.

Si predikatar ishte shumë i njohur, sa që e njihte mbarë bota e krishterë. Për këtë që nga shekulli i shtatë e quajnë edhe Gjon Gojarti. Shumicën e veprave, të cilat ishin kryesisht predikime, i shkruan në dymbëdhjetë vitet e para të meshtarisë. Gjoni bëri predikime të shumta, sepse lexonte shumë Shkrimin shenjt, lutej dhe meditonte. Gjonin e krahasonin me oratorin e madh grek, Demostenin. Posaçërisht behët i njohur me veprën e vet *De Statuis* – pretek i kohës së kreshmëve, në të cilin flet për fatkeqësinë e popullit. Behet fjalë për shkatërrimin e disa monumenteve historike dhe kulturore të të krishterëve, në shenjë pezmatimi ndaj perandorit Teodoz, i cili kishte dhënë urdhrë për pagëse të disa tatimeve.

Pas vdekjes së patrikut të Konstantinopojës, Nektarit, Gjoni bëhet zëvendës i tij. Shugurohet për ipeshkëv me 398 nga duart e Teofilit për shërbim në Aleksandri. Ishte vështirë për popullin e Antiokisë që Gjon Gojarti të largohet prej tyre dhe

të shkojë në Aleksandri. Pasi që populli nuk dëshironte të pajtohej me një vendim të tillë, flitet se Gjoni u detyrua fshehurazi ta lëshojë Antiokinë, për të shkuar në Konstantinopojë.

Në Konstantinopojë gjendja ishte shumë e rëndë, sepse ishin disa probleme në mes meshtarëve dhe shtresave tjera në popull. Për fat të keq tek meshtarët ishte problem simonia. Ipeshkvi i mëparshëm nuk e kishte marrë

të cilëve u konvenonte problemi në Kishë dhe në popull. Gjoni ra në kundërshtim të madh me perandoreshën Eudoksia, e cila udhëhiqte shtetin dhe gjithçka bëhej siç thoshte ajo, e jo burri i saj Arkadi.

Në mbledhjen e Kalcedonit në vitin 403 e gjykojnë veprën e Gjoni, kinse për fyerjet që ia bëri perandoreshës dhe perandorit dhe e përjashtojnë nga Konstantinopojë. Perandori kërkon që ai

në këtë botë dhe asgjë nga kjo botë nuk do të marrim me vete. Në goftë se Krishti është me mua, kujt t'i frikësohem?

Të tretën ditë ai vetë dorëzohet dhe vërtetë e largojnë përtej Bosforit. Pas dy ditëve ndodhi një termet i madh dhe të drejtët thanë se ky është ndëshkim i Zotit që e larguam njeriun e Zotit. Me këtë rast perandori bëri amnisti dhe Gjoni u kthye prapë në Konstantinopojë. Njerëzit ia bënë një pritje madhështore. Ndërkaq kundërshtarët e tij, e me ta edhe njëfarë Teofili, ikën nga qyteti, sepse u frikësuan nga hakmarja e popullit.

Vështirë qetësohej situata në qytet. Gjithnjë kishte trazira. Pranë katedrales të pafetë kishin ndërtuar një trupore të perandoreshës dhe aty çdo ditë vallëzonin e pengonin. Gjoni për këtë u ankua tek prefekti i qytetit, ndërsa perandoresha prapë kërkoj që ai të largohet për fyerje që kinse Gjoni i bëri asaj. Dhe Gjoni në festën e Shën Gjoni martir ndër të tjera predikon: *Prapë çartet Herodiada, prapë vallëzon dhe kërkon në pjatë kokën e Gjoni.* Thirret një sinod nga perandoresha dhe sipas nenit 12 të koncilin të Antiokisë i ndalohen të gjitha të drejtat për të kryer detyrën njeriun që është i përjashtuar. Ai mund të kthehet në detyrë vetëm atëherë kur thirret ndonjë mbledhje tjetër dhe e shfuqizon këtë ligj.

Të Shtunën e Madhe u pagëzuan rreth tremijë katekumenë, por Gjoni nuk mund të ishte pjesë marrës, sepse ishte i ndaluar me armë. Gjoni duke e parë se mund të vijë deri tek gjakderdhja, në festën e Rrëshajëve tërhiqet prej vendit. Për një kohë qëndron në Armeni ku krijoi një simpati dhe shumë njerëz shkonin për t'i dëgjuar predikimet e tij, pastaj u tërhoq në pjesën lindore të Detit

të Zi. Këtu ndërron jetë me 14. IX. 407.

Më lart e cekëm se Gjoni ishte gojartë. Ai ar i vinte nga zemra, sepse jetën e vet e shkriu për Zotin dhe në shërbim të popullit.

Veprat

Egzegjeza e predikimeve. Në këto predikime Gjoni provon të zbulojë së pari kuptimin historik të Shkrimit shenjt. Lirisht mund të themi se të rrallë janë egzegjetët që kanë mundësinë aq bukur dhe tërësisht ta zhvillojnë dhe shtjellojnë Shkrimin shenjt sikurse Gjoni.

Predikimet dogmatike dhe polemikat

De incomprehensibili Dei natura – Mbi natyrën e pakuptueshme të Zotit. Gjoni këtu ka dymbëdhjetë predikime, pesë të përgatitura në Antioki, ndërsa shtatë në Konstantinopojë.

Katehezat e pagëzimit. Në Antioki Gjoni kishte detyrë të përgatiste katekumenët për marrjen e sakramenteve. Nga këto janë tetë fjalime. Disa u gjetën në vitin 1955 nga A. Venger në Atos. Këto fjalime nuk flasin për sakramentet, por për moralin e krishterë dhe jetën sipas hirit, të gjitha këto të bazuara në letrat e shën Palit.

Adversus Iudaeos orationes – Fjalimet kundër judenjve. Këtu kemi tetë fjalime kundër judenjve, të cilat i pati mbajtur në Antioki. Arsyja e predikimeve ishte se shumë të krishterë merrnin pjesë në festat e judenjve, të cilët nuk e kishin pranuar Mesinë, prandaj Gjoni thoshte: *“Nuk kenë të drejtë të festoni, të hani e të pini me ta, më në fund as të shkonë pas tyre.”*

Fjalime me tematikë morale

Contra Iudeos et theatra – Kundra judenjve dhe teatrit. Ishte ky një fjalim i njohur në Konstantinopojë. Gjoni ishte kundër lojërave të ndryshme. Të krishterët lënin meshë, ndodhte edhe ritet e së Premtes së Madhe, e shkonin në lojëra të tilla. Ngjante që edhe për Pashkë të lënin meshë për t'u zbavitur në lojëra që organizonin judenjtë.

Gjoni ka shkruar edhe shumë vepra të tjera më pak të njohura.



Gjon Gojarti, reljef bizantin nga shek. II, Louvre - Paris

seriozisht këtë problem. Tani Gjoni i mbetet që nëpërmes reformave *in capite et in membris* (në krye e në gjymtyrë) të arrijë që ta normalizojë gjendjen dhe të ecën puna mbarë, siç dëshiron Zoti.

Për këtë reformë Gjoni has në kundërshtim me njerëz të pa fe,

të largohej përtej Bosforit. Me këtë rast Gjoni e mban një pretek, i cili e ka këtë përmbytje:

“Kujt t'i frikësohem? Vdekjes? Krishti është jeta ime, vdekja është fitesë. A thua salvimit? E Zotit është toka dhe çdo gjë në të. A thua bumbja e të mirave tokësore do të më frikësojë? Asgjë nuk kemi sjellë

Me rastin e festës së Shën Joakimit e Anës, prindërit e Virgjërës Mari

Gjyshërit tanë në familje dhe qëndrimi ynë ndaj tyre

Pikërisht në zemër të verës, kur familjet, për të shpëtuar nga vapa e nga zagushia, kërkojnë freski, çlodhje e prehje ndër bjeshkë, liqene e bregdete, duke i lënë pleqtë në shtëpi vetëm, ose duke iu bërë shtrojë, nëse nuk janë më të zotët e vetes, ndër shtretër spitalesh, ku nga njëherë mbeten për një kohë të gjatë; bie festa e Shën Joakimit e Anës, prindër fatlumë të Zojes së Bekuar e gjyshër të Jezusit, shembull e pajtorë të vatrave familjare e të gjyshërve tanë. Ashtu si i është kushtuar, gjatë vitit, një ditë baballarëve e një ditë nënave, ndoshta-ndoshta për t'ua kthyer në një farë mënyre, me dhurata, borxhin e pakthyeshëm

për t'u shprehur mirënjohjen, respektin, solidaritetin, për urtinë e fituar përmes përvojës së viteve e për flijimet, më tepër se gëzimet në jetë, mund të jetë edhe ky 26 korrik. Tradita fetare e popullore e festës së gjyshërve të Jezusit, përmes dokeve, zakoneve e ikonografisë së këtyre shenjtorëve, na fton të kujtohemi për gjyshërit tonë, të cilët shpesh herë e ndiejnë veten të harruar, gati-gati pa emër, jo vetëm ndër qytete por, për fat të keq, tashmë edhe ndër viset e humbura, gjysmë të shkreta, ku lihen në mëshirën e minjve e të hajdutëve. Tradita e lashtë na kujton se braktisja tashmë po ndjehet edhe atje, ku deri dje gjyshërit ishin shtyllat krye-

të rinjve. E ajo që është më shqetësuese – kanë ndryshuar edhe marrëdhëniet ndërmjet brezëve, duke krijuar rrezikun e ndeshjes ndërmjet tyre. Me humbjen e drejtësishtimit të moshave, paga e pensionistëve rëndon gjithnjë më shumë mbi kurrizin e të rinjve. Atëherë të rinjtë nisin t'i shikojnë pleqtë si barrë, si njerëz që kushtojnë tepër, që u zënë banesat e u kufizojnë kohën e lirë. E çështje më keq, u kujtojnë vazhdimisht si do të bëhen, kur të plaken. E natyrisht, plakja progresive e shoqërisë kërkon edhe strategji të reja shëndetësore, modele të reja ndihme, me qëllim përmirësimin e jetën e njerëzve që i kanë kapërcyer të

Por të kthehemi tek traditat e bukura të kohëve jo shumë të largëta. Në këtë periudhë, sipas një tradite të lashtë, fshatarët, për të shpëtuar nga vapa e banesës, e kremtonin një festë tradicionale me këngë e valle në ajër të pastër, larg shtëpive, në freskinë e netëve verore, nën qiellin plot yje. Hanin e pinin gjithë natën prodhimet më tipike të verës, duke nisur me verë e duke përfunduar me shalqi. Për t'i larguar njerëzit nga teprimet, Kisha radhiti në liturgji kujtimin e Shën Jakut e të Shën Anës, si ideale jete e shembull të zakoneve të mira familjare. Kulti i dy shenjtëve, të cilët i njohim përmes traditës, Etërve të Kishës si Protoungjillit të Jakut (vepër apokrifë e shekullit II), shumë i lashtë tek grekët, sipat posaçërisht në shekullin VI. Prej tyre dalë-nga-dalë u shtri edhe në Perëndim. Tek grekët Shën Ana kujtohej më 25 korrik, tek

blerimi, i zbehur nga vapa, kanë nevojë për ujë frytet ndër pemë e rrushi ndër vreshta. Kur bie shi më 26 korrik, konsiderohet si shi i bekuar. E pleqtë rrëfejnë se gjëja më e çmuar që Ana, kur u nis nuse, i solli si pajë Joakimit (Jakut), bari grigjash, ishte pikërisht uji.

Gjyshat e gjyshet, nënat e nusët i nderojnë dy shenjtorët si pajtorë e tyre qiellorë, si shembull për jetën e tyre familjare e bashkëshortore, jetuar në frymën e lutjes biblike dhe të respektimit të ligjit të Zotit.

Në figurat e Shën Anës e të Shën Joakinit, shpesh i shikojmë me dorën mbështetur mbi Bibël, në sa i mësojnë psalme e lutje Bijës së tyre të zgjedhur, që do të bëhej "e bekuar mbi të gjitha grate". Pikërisht për këtë, në mbasdreket e gjata verore, ndërshin prindërit ishin ende ndër ara e vreshta, ose kishin nisur të endnin lirin e mëndafshin, gjyshet



Takimi i Joakimit dhe Anës tek dera e artë, pikur nga shek. 15-të

që u kanë bjtë, disa antropologë mendojnë se është e natyrshme që edhe gjyshërve t'u kushtohet një ditë e tillë, për të spastruar kështu sado pak lëmashkun e indiferencës që shrohet mbi marrëdhëniet ndërmjet tyre e të rinjve.

Një ndër ditët e përshtatshme

sore të shtëpisë e të familjes, ku fjala e tyre ishte urdhër, prania gëzim e fjala shkollë.

Në botën perëndimore numri i pleqve vjen gjithnjë duke u rritur, ndërsa ai i të rinjve, duke u bërë gjithë më i vogël. Në viti 2020 parashikohet që numri i pleqve të jetë më i madh se sa ai i

75-sat. Njerëz me moshë të tillë krijojnë dy probleme kryesore: atë të vetmisë, sepse nuk sigurojnë më mbështetjen e familjes, e atë të rrezikut të humbjes së vetëveprimit fizik ose psikik. E kështu figura e njeriut të moshuar po e humbet plotësisht vendin që kishte dikur në gjirin e familjes.

“ Në mbasdreket e gjata verore, ndërsa prindërit ishin ende ndër ara e vreshta, ose kishin nisur të endnin lirin e mëndafshin, gjyshet dikur u lexonin nipave faqe nga historia e shenjtë e u mësonin lutje të bukura, që thuheshin me zë të lehtë, melodioz e sigurisht, me gjithë zemër, për të mos u harruar më gjithë jetën. E gjyshet nuk harronin të përgatisnin edhe ëmbëlsira të këndshme, gatuar me frytet e stinës, me kumbulla e kajsi, të cilat haheshin rreth sofrës familjare, duke krijuar një atmosferë të mrekullueshme paqeje e mirëkuptimi ndërmjet brezave. ”

latinët, më 26. Ndërsa Shën Joakini në fillim nisi të kremtohej më 20 mars, pastaj - të dielën e parë pas 15 gushtit, kur kremtohet Të ngriturit e Zojes në qiell, më pas më 16 gusht e, me kalendarin e ri liturgjik, në të njëjtën ditë me fatin (bashkëshorten) e vet, Shën Anën, më 26 korrik. Në pëshpirtërinë popullore shenjtorët nderohen edhe si pajtorë të prodhimeve të stinës që pihen ndër kopshte e ndër ara. Në këto javë toka zhuritet e ka nevojë për ujë. Për ujë ka nevojë

dikur u lexonin nipave faqe nga historia e shenjtë e u mësonin lutje të bukura, që thuheshin me zë të lehtë, melodioz e sigurisht, me gjithë zemër, për të mos u harruar më gjithë jetën. E gjyshet nuk harronin të përgatisnin edhe ëmbëlsira të këndshme, gatuar me frytet e stinës, me kumbulla e kajsi, të cilat haheshin rreth sofrës familjare, duke krijuar një atmosferë të mrekullueshme paqeje e mirëkuptimi ndërmjet brezave. (Marrë nga Radio Vatikan në gjuhën shqipe)

Dita XXII Botërore e Rinisë – Sydney 12 – 21 korrik 2008

TË RINJTË – profetë të epokës së re me fuqinë e Sh

Takimi tradicional i Ditës Botërore të Rinisë, që sivjet ishte XXIII me radhë, u mbajt në Sydney të Australisë. Sipas statistikave, ishin të pranishëm mbi 50 mijë të rinj nga e gjithë bota e krishterë. Mesha solemne u mbajt më Hipodromin e Sydneyt në Randwick, në udhëheqjen e Papës Benedikt XVI dhe shumë kardinalëve dhe ipeshkvijve të ardhur enkas për këtë manifestim botëror. Papa i ka ftuar të rinjtë që të kenë guximin e dëshmisë së identitetit të tyre për që qenë profetë të një epoke të re të krishterë, ku do të respektohet jetë e dinjitetshme me dashuri, në mënyrë që të shmanget “shkretëtira shpirtërore” që e ka kapluar shoqërinë tonë.

■ SHKRUAN:
Don Fatmir KOLIQI

Dita Botërore e Rinisë 2008, e 23-ta me radhë, u mbajt sivjet në Sydney të Australisë. Morën pjesë më tepër se 50.000 të rinj nga 170 shtete të botës. Madhështinë e manifestimit e ka shtuar prania e shenjtërisë së tij Papa Benedikt XVI, me përcjellës kardinalë e ipeshkvij nga Vatikani, si sekretari i shtetit Tarcisio Bertone, dhe ipeshkvij e meshtarë nga mbarë bota.

Papa Benedikt XVI kishte mbërrirë në Australi më 13 korrik, ku në aeroportin e Sydneyt e pritën autoritetet shtetërore, kryeministri Rudd, përfaqësues të kishës kardinali George Pell, nunci apostolik Giuseppe Lazzarotto, përfaqësues të pushtetit lokal, përfaqësues të organizimit të Ditës botërore të rinisë në krye kryetarit e Këshillit Papnor për laik kardinalin Stanisław Ryłko dhe disa besimtarë. Pas pak minutash të bërës së Papës, ai u nis me automobil për në Qendrën e Studimeve Kenthurst, ku ka qëndruar disa ditë për pushim, deri më 17 korrik kur është takuar me të rinjtë e gjithë botës. Ky udhëtim është i nënti me radhë i Papës jashtë Italisë.

Tema e sivjetme e takimit të rinisë ishte: “Do të merrni fuqinë e Shpirtit Shenjt, i cili do të zbrisë në ju dhe ju do të bëheni dëshmitarë të mi” (Vap 1, 8). Me këtë temë Benedikt XVI kishte dhënë porositë qysh vitin e kaluar, duke shtjelluar rolin e Shpirtit të Shenjt në jetën e Kishës, në jetën e secilit të krishterë e në veçanti tek të rinjtë e krishterë.


“Besoni në fuqinë e Shpirtit Shenjt për ta shndërruar botën”

Të rinj nga mbarë bota natën e ditës së madhe, më 19 korrik, kishin pritur Papën për lutjen e mbrëmjes në Randwick. Duartrokitjet e stuhishme, koret e ritmuara e valëvitjet e vijueshme të flamujve ngjyra-ngjyra, përshëndetjen arritjen e Papës, shoqëruar nga 12 shtegtarë, në tribunën e kuqe, mbi të cilën lartohej një kryq i ndritshëm dhe “Zogu i Marzhorisë”, simbol i Shpirtit Shenjt, pikturuar nga një aborigjene. Me Himnin e DBR-së, kënduar nga një kor prej 300 këngëtarësh në të gjitha gjuhët, hyrja e Papës u paraprir nga simbolet e Ditës: Kryqi dhe ikona e Zojes së Bekuar. Papa në homilinë e tij tha: “Duke e pranuar pushtetin e Shpirtit të Shenjt, mund t’i shndërroni familjet tuaja, bashkësitë, kombet. Veproni në mënyrë të tillë, që, dhuratat e dijes, të intelektit, të forcës, të shkencës e të mësirës, të jenë shenjat dalluese të madhështisë suaj.” Fjalimin e Papës e pasuan çaste përqendrimi në lutje e adhurimi të të Shenjtueshmit Sakrament. Të rinjtë mbetën në Hipodrom tërë natën duke adhruar Sakramentin, duke u lutur e duke heshtur.

“Hapjani zemrat forcës së Shpirtit Shenjt, për t’i çuar botës Krishtin”

Mesha qendrore e Takimit ishte më 20 korrik në Hipodromin Randwick të Sydneyt, që konsiderohet mesha më e madhe në historinë e kontinentit. Papa arriti me helikopter e pastaj kaloi ndërmjet radhëve të tyre me pamobil. Në elterin e kuq u ngjiten 500 kardinaj, ipeshkvij e meshtarë bashkëkremtues. Meshën e shoqëroi

një kor me 300 zëra e 80 instrumente muzikore. Në fillim të Meshës, kardinali Pell i falënderoi të gjithë ata, që dhanë kontributin e tyre për suksesin e kësaj DBR-së e sidomos të rinjtë që, pa marrë parasysh flajmet, erdhën këtu nga vende të largëta. Ju – nënvizoi kardinali – e nderuat Australinë me praninë tuaj e me entuziazmin tuaj. Gjatë Meshës Ungjilli u soll me valle nga një grup seminaristësh të Figjit, veshur me kostume tipike tradicionale. Pastaj 24 të rinj nga mbarë bota morën Sakramentin e Krezmimit. “Zoti kërkon nga ju të jeni profetë të epokës së re, lajmëtarë të dashurisë së tij, të aftë për t’i tërhequr njerëzit drejt Atit e për të ndërtuar një ardhmëri plot shpresë për mbarë njerëzimin – u tha të rinjve Papa, duke riovënë në qendër të homelisë temën e Shpirtit të Shenjt, që na bën dëshmitarë të tij. Forca e Shpirtit të Shenjt është forcë e jetës së Hyjit – vijoi Benedikt XVI – është fuqi e atij Shpirti, që e ngjalli Jezusin nga të vdekurit. Është forca që na prin ne e i prin edhe botës sonë drejt mbretërisë së Hyjit. Por hiri i Shpirtit Shenjt – kujtoi Papa – nuk është diçka që mund ta meritojmë, ose ta fitojmë; mund ta marrim vetëm si dhuratë. E kjo dhuratë, të cilën duhet ta kërkojmë me lutje, është e vëmëja që mund të fitojë mbi indiferencën tonë, mbi lodhjen tonë, mbi prirjen për t’u përshtatur kohës sonë. Benedikt XVI u drejtoi të rinjve pyetjet: ‘Ç’do t’u lini trashëgim brezit tuaj të ardhshëm?’ e ‘A ia krijoni hapësirën e dubur Shpirtit Shenjt, në mes të një bote që do ta harrojë Zotin ose ta flakë, në emër të konceptit të një lirie të rrëmbe?’ E përforcuar nga Shpirti Shenjt, breznia e re e të krishterëve është e thirrur të kontribuojë për ndërtimin



Autorja e simbolit të DBR-së Sydney 2008, është Marzhori Lidi, aborigjene vendase nga ishujt e largët Tiwi. Kjo grua që nuk ka pikturuar kurrë në jetën e saj, skicoi me teknikën aborigjene pika-pika, zogun që pa në një vegim nate. I ngjet një pëllumbi me aureolë të artë rreth kokës. Sipas ipeshkvijve australianë, zogu i skicuar i afrohet shumë simbolit, me të cilin Kisha paraqet Shpirtin e Shenjtë. Legjenda e zogut të Marzhorisë u bë e njohur në të gjithë Kishën australiane, e cila e zgjodhi si figurë kryesore të DBR-së. Kardinalitë e ipeshkvijtë e mbarë botës bartën këtë figurë në shpinë të petkave të meshës ngjyrë dheu të djegur, dhe Papa e kremtojë Meshën pikërisht nën krahët e hapur të zogut, vendosur mbi elterin e ngritur në Randwick.

pirtit Shenjt



Papa Benedikti XVI gjatë meshës, më 20 korrik, në Randwick Racecourse

një bote, në të cilën jeta mirëpritet, përkujdeset me dashuri, pranohet, nuk shikohet si kërcënim e, prej këndej, nuk shkatërron – theksoi me forcë Benedikti XVI – që në vijim pikturoi botën e re, në të cilën dashuria nuk është e pangopur dhe egoiste, por e pastër, besnike dhe e lirë, plot respekt për dinjitetin e tjetrit, dashuri që të shtyn drejt së mirës e që rrezaton gëzim e bukuri. Në këtë epokë të re, shpresa do të na çlirojë nga cektësia, nga amullia e nga mbyllja në vetvete, që i lëndojnë shpirtat tonë e i vlerosin marrëdhëniet njerëzore. Kisha ka nevojë për këtë përtitje – theksoi Ati i Shenjtë. Kisha ka nevojë për gjithë të rinjtë. Ka nevojë të rritet në forcën e Shpirtit Shenjt, që edhe sot ju jep gëzim

e ju frymëzon t'i shërbeni plot hare Zotit. Të jesh i vulosur me Shpirtin Shenjt, do të thotë të mos kesh frikë ta mbrosh Krishtin, duke e lënë dritën e Ungjillit të na e ndriçojë mënyrën si shohim, si mendojmë e si veprojmë, ndërsa punojmë për fitoren e qytetërimit të dashurisë. Uroj që Ditën e 23-të Botërore të Rinisë – tha në përfundim Papa – ta keni jetuar si një Çenakull i ri, kështu që të gjithë ne, të përflakur nga zjarri i Shpirtit Shenjt, t'ia kumtojmë Zotin të gjithëve, duke tërhequr çdo zemër drejt Tij”.

Dita Botërore e 24 me radhë do të jetë në Madrid 2011.

Vetë Papa në mbarim të meshës, pas lutjes së Engjëlli Tenzot, njoftoj se

DBR –ja e ardhshme do të jetë në Madrid më 2011. Të rinjtë spanjollë shpërthyen në brohoritje të fuqishme, kur dëgjuan se DBR-së e 2011-tës do të mbahet në Madrid. Shumë nga të rinjtë spanjollë u ngjiten në altarin papnor, duke shpalosur bluzat e kuqe me shkrimin “Sydney 2008 - Madrid 2011”. Veprimtaria e fundit të Papës në tokën australiane ishte takimi me bamirësit dhe organizatorët e DBR-së, të cilët i falënderoi për suksesin. Së fundi, në orën 9.30 me orën vendase, 2 pas mesnate me atë evropiane, u organizua ceremonia e lamtumirës në aeroportin ndërkombëtar të Sydneyt. Përfundoi, kështu, shtegtimi i 9 apostolik i Benedikt XVI.



Të rinjtë e bartin kryqin e madh për ta vendosur në altarin e Randwick

Pjesë nga porosia e Papës Benedikt XVI drejtuar të rinjve një vit më parë

“Shumë të rinj e shohin jetën e tyre me shqetësim dhe i bëjnë vetes shumë pyetje rreth së ardhmes së tyre. Ata pyesin veten të shqetësuar: Si të hyjmë në një botë të shenjuar nga padrejtësi të shumta e të rënda dhe vuajtje? Si të reagojmë ndaj egoizmit dhe dhunës që ndonjëherë duket se fitojnë? Si t'i japim një kuptim të plotë jetës? Si të kontribuojmë në mënyrë që frytet e Shpirtit që kemi kujtuar më parë, “dashuria, hareja, paqja, duresa, dashamirësia, mirësia, besnikëria, butësia, përkormëria” (nr. 6), ta mbushin këtë botë të plagosur e të brishtë, sidomos botën e të rinjve? Në ç’kushte Shpirti gjallëruet i krijimit të parë dhe sidomos i krijimit të dytë apo shëlbimit mund të bëhet shpirti i ri i njerëzimit? Mos të harrojmë se sa më e madhe të jetë dhurata e Hyjit – dhe ajo e Shpirtit të Jezusit është më e madhja – po aq e madhe është nevoja e botës për ta marrë. E pra i madh dhe apasionues është misioni i Kishës për të dhënë dëshmi të besueshme. Ju të rinj, me Ditën Botërore të Rinisë, në një farë mënyre tregoni vullnetin për të marrë pjesë në këtë mision. Edhe një herë ju përsëris se vetëm Krishti mund t'i përbushë aspiratat më intime të zemrës së njeriut; vetëm Ai është i aftë ta njerëzojë njerëzimin dhe ta çojë drejt “hyjnzimit” të tij. (...) “Duhet të rinj që të lënë të dëgjat brenda tyre dashurinë e Hyjit dhe t'i përgjigjen bujarisht thirrjes së tij urgjente, siç kanë bërë shumë të rinj të lumtur e shenjtë të së kaluarës dhe edhe të kohëve më pranë nesh. Në veçanti ju siguroj se Shpirti i Jezusit ju fton sot ju të rinjve të jeni mbarbës të lajmit të mirë të Jezusit për bashkëmoshatarët tuaj. Vështrësia që pa dyshim ndeshin të rriturit në afrimin e sferës së rinisë në mënyrë të kuptueshme dhe bindëse mund të jetë një shenjë me të cilën Shpirti do t'ju shtyjë ju të rinjtë që të ngarkoheni me këtë barrë. Ju njihni idelat, ojuhet, dhe edhe plagët, pritshmëritë, dhe së bashku dëshirën e bashkëmoshatarëve tuaj për të mirën. Çelet bota e gjerë e dashurive, e punës, e formimit, e pritjes, e vuajtjes rinore... Secili prej jush të ketë guximin t'i premtojë Shpirtit Shenjt se do t'i sjellë një të ri Jezu Krishtit, në mënyrën që i duket më e mira, duke ditur t'i “jepni përgjigje gjithsecilit që prej jush kërkon arsyen e shpresës që është në ju, me butësi” (khs 1 Pjt 3:15).



Imzot Dodë Gjergji dhe akademik Mark Krasniqi.
Foto e Takimeve të Don Mikel Tarabullazit në Stube

Foto: Petrit Prenaj

Intervistë me akademik Mark Krasniqin

Seminari katolik dhe gjimnazi real në burime të edukimit

Si ju kujtohet gjendja e Kishës Katolike pas ardhjes së komunizmit, persekutimet, keqtrajtimet, vrasja e atdheut Bernard Llutit, burgosja e meshtarëve etj.?

M. Krasniqi: Qeveria komuniste mori pushtetin kah fundi i vitit 1944 dhe shpalli politiken e "Bashkim – Vllaznimit". Madje nxori ligje dhe kushtetutën në këtë frymë. Mirëpo, të gjitha këto ishin vetëm në letër, sa për sy e faqe, për ta mashtruar opinionin ndërkombëtar se Jugosllavia komuniste është shtet demokratik dhe human. Realiteti ishte krejtësisht i kundërt. Menjëherë pushteti serbo-komunist mori masa drastike para së gjithash ndaj shqiptarëve. Filluan burgimet, terrori dhe pushkatimet masive të njerëzve të pafajshëm, të cilët akuzoheshin si ballistë, fashistë, armiq të popullit etj. Komunizmi i shpalli luftë edhe fesë – kishës e xhamisë. Në shënjestrë ka qenë sidomos kleri katolik, por nuk e kanë kursyer as klerin mysliman shqiptar.

Qëndrimi burrëror i Bernard Llutit dhe Marije Shllakut në gjyqin komunist

Si gazetar kam marrë pjesë në dy-tri seanca të gjyqimit të atdheut Bernard Llutit e Marie Shllakut, më 1946 në Prizren. Atë Bernard Llutit, famullitar në Pejë, mbante qëndrim dinjitoz, burrëror me mbrojtjen e tij të logjikshme dhe bindëse. Ai akuzohej nga prokurori Ali Shukrija si armik i popullit, si përkrahës i Marije Shllakut dhe i ballistëve të tjerë. Marije Shllaku, një studente shkodrane 22 vjeçare, kishte marrë pjesë në luftën e Shaban Polluzhës. Ajo ishte e plagosur, e torturuar, e dërmuar, por mbahej dhe mbrohej si heroinë e vërtetë. Unë kurrë nuk i harroi atë frat e atë vajzë shqiptare, këta atdhetarë të ndershëm shkodranë,

që luftuan për lirinë e Kosovës dhe dhanë jetën për idealin kombëtar. Është trimëri antologjike mbrojtja e Marije Shllakut para akuzave të prokurorit komunist Ali Shukrisë, i cili e pyeti: "Po të kishit fituar luftën ju armiq të popullit, çka do të kishit bërë kundër nesh çlirimtarëve të popullit?" Marija me zë të lartë e me vendosmëri ia ktheu: "Po të kishim fituar luftën ne naciona-

ndër të tjera thuhet se unë paskam pasur gisht në gjykimin e Marije Shllakut!... Gishti im ka qenë ky që thashë, kurse ai paska pasur gisht në UDB-ën qysh si nxënës i gjimnazit të Pejës, kur çdo ditë shkonte në shkollë me revolen e policisë sekrete serbe në çantën e librave, siç tregojnë shokët e tij të shkollës. Ajo UDB, siç dihet, ua ka pirë gjakun, ua ka marrë jetën njëjra e njëjra

“Seminari ishte një lloj konvikt, me disiplinë të madhe, por me të gjitha kushtet shumë të mira për jetesë, për mësim dhe edukim. Çdo gjë ishte me orar të caktuar – ushqimi, fjetja, zgjimi dhe përgatitja e lëndëve mësimore për gjimnaz, ku shkonim të gjithë së bashku në mëngjes.”

listët e ndershëm shqiptarë, unë juve tradhtarëve të popullit, si duhanin ju kisha gri!" Marija e dinte se është para ekzekutimit, para vdekjes, por asaj nuk i trembej syri dhe armikut ia dha përgjigjen flakë për flakë, të cilën ai nuk e priste, por e meritonte. Unë raportin nga seanca gjyqësore ia dorëzoja gazetës me fjalët e padisë së prokurorit dhe me mbrojtjen e të akuzuarve. Mirëpo, në gazetë dilte teksti krejtësisht ndryshe. Mbrojtjen e të akuzuarve e ndryshonte censura, dilte krejt ndryshe nga teksti im. Unë pastaj refuzova të marr pjesë në gjykim. Shef i mjeteve të informimit ka qenë komunisti i njohur Predrag Ajtiqi. Në ato ditë vendosej për bursat e studentëve të ardhshëm. Të gjithë studentëve kosovarë ua dhanë bursën nga 1500 dinarë, përveç meje.

Një koïncidencë e rastit në lidhje me këtë intervistë: Para disa vitesh (2004) në një webfaqe të internetit "Iliria" akuzohem prej një kundërshtari timi. Aty

shqiptarëve të ndershëm, ndër të cilët ka pasur shumë klerikë shqiptarë, të cilët kanë pësuar tortura të tmerrshme në burgjet jugosllave, siç ka qenë ipeshkvi imzot Nikë Prela, Dom Pjetër Berisha nga Prizreni, Dom Dedë Ramaj nga Stublla, Dom Mark Shiroka nga Prizreni e të tjerë. Madje, Dom Marku, të cilin e kam njohur mirë, ka qenë axha i një personi, i cili ka qenë udhëheqës i lartë në pushtet dhe në Partinë Komuniste. Kur e kanë burgosur, unë e kam lutë atë nip të tij, të cilin e kam pasur shok shkollë në gjimnazin e Prizrenit, që të përpigjet për lirinë e axhës së tij, Dom Markut, i cili ka qenë njeri i urtë dhe i pafajshëm, por nëse ka predikuar në kishë që besimtarët sot duhet ta mbrojnë e ta ruajnë fenë e tyre, nuk ka bërë kurrfarë gabimi që meriton burgun. Kështu e kanë burgosur serbët edhe mulla Bah-tijar Qafleshin, një hoxhë i urtë dhe atdhetar nga Opoja, të cilin e kam pasur shok qysh më 1941.

Në atë kohë feja, sidomos kle-

ri katolik në Shqipëri, ka kaluar edhe më keq nga terrori i sistemit shtetëror komunist, kur u ndalua feja dhe u mbyllën të gjitha kishat e xhamitë, u burgosën klerikët katolikë dhe shumë u pushkatuan. Por as kleri myslimanë nuk ka kaluar më mirë. Madje, edhe Patër Gjergj Fishtës, Homerit shqiptar, ia nxorën eshtrat nga varri dhe i hodhën në Bunë. U pushkatuan shumë intelektualë të lartë të tjerë, ndër të cilët edhe Patër Anton Harapi, me shumë shokë. Në Tivar, më 1945 u likuiduan brenda ditës 4200 djem shqiptarë, të mobilizuar, por pa armë, gjoja për të luftuar kundër nazistëve gjermanë në Istër e në Slloveni. Nuk duhet të harrohen kurrë krimet e tilla të Serbisë ndaj popullit shqiptar. Politika serbe gjithmonë, gjatë shekujve ka qenë dhe është pushtimi i trojeve shqiptare dhe zhdukja fizike e popullit shqiptar. Këtë politikë të okupatorit serb e kemi provuar në shpinën tonë në Kosovë edhe në vitet nëntëdhjeta të shekullit XX.

Seminari katolik dhe gjimnazi real në Prizren – burime të edukimit e të mësimit

Cila ka qenë përvoja juaj në gjimnazin real në Prizren. A ka pasur ndikim në përgatitjen tuaj të mëtejme, meqenëse tashmë dihet kalibri juaj intelektual

M. Krasniqi: Në kohën e Jugosllavisë monarkiste shkolla fillore ka qenë 4 e gjimnazi 8 vjet. Për të thënë të vërtetën, gjimnazi ka qenë shumë rigoroz. Madje, në Kosovë ka pasur shumë profesorë kroatë e sllovenë me përgatitje solide profesionale, të cilët pushteti i transferonte këtej si dënim për arsye të qëndrimeve të tyre politike liberale e demokratike. Shkolla e librit shqip, në kohën e Jugosllavisë monarkiste kanë qenë rreptësisht të ndaluara. Madje, politika antishqiptare e

Beogradit bënte çmos për të mos u shkolluar rinia shqiptare as në gjuhën serbe, kështu që nxënësit shqiptarë ishin shumë të rrallë, por edhe mundësitë e prindërve për të shkolluar fëmijët e tyre ishin minimale, madje në fshatra nuk ekzistoni fare. Kështu ka qenë rasti edhe me prindërit e mi. Unë vetë isha rast i rrallë. Ky rast ngjau kështu: Për krezmim të fëmijëve erdhi ipeshkvi Imzot Ivan Gnidovec në kishën famullitare në Glogjan. Ndër ata fëmijë isha edhe unë. Ipeshkvi ishte slloven, por dinte edhe shqip. Ai mbajti një predikim, në të cilin apeloj që të shkollohet rinia. Madje, ai tha se për disa nxënës ekziston mundësia që në Seminarin katolik në Prizren të pranohen pa pagesë, ta kryejnë gjimnazin dhe të vazhdojnë shkollimin në Fakultetin teologjik në Kroaci. Unë e shfrytëzoja këtë mundësi. Seminari ishte një lloj konvikt, me disiplinë të madhe, por me të gjitha kushtet shumë të mira për jetesë, për mësim dhe edukim. Çdo gjë ishte me orar të caktuar – ushqimi, fjetja, zgjimi dhe përgatitja e lëndëve mësimore për gjimnaz, ku shkonim të gjithë së bashku në mëngjes. Edhe në seminar ishim pak shqiptarë, shumica ishin kroatë nga Janjeva, sllovenë e të tjerë. Unë e kisha shok Gjon Sereqin, të cilin e pushkatuan më 1946 në Prishtinë, ku ishte profesor i gjimnazit, si nacionalist i dalluar në organizatën kombëtare NDSH. Unë diplomova në gjimnazin e Prizrenit më 1941, kur u shkatërrua Jugosllavia dhe u mbyll Seminari. Në realitet në Prizren me seminaristët kishim dy shkolla: në Seminarin katolik – disiplinë e mësim individual, edukatë qytetare e fetare, kurse në gjimnazin shtetëror – mësim rigoroz. Megjithatë qëllimi i seminarit ishte vazhdimi i shkollimit në teologji, askush nuk bënte presion që të ndiqet kjo rrugë, kështu që as vetë nuk shkova në Kroaci në teologji, po në Itali, me bursën që ua dha ministri i arsimit Er-

Prizren – e të mësimit (I)

nest Koliqi të gjithë maturantëve kosovarë. Unë në Universitetin e Padovës, në Fakultetin filozofik, studiova letërsinë dy vjet.

Falë edukatës dhe disiplinës solide në seminarin dhe në gjimnazin shtetëror, ku përveç tjerash fitova edhe shprehinë e punës, unë në Padovë i dhashë provimet gati nga të gjitha lëndët e dy viteve të para, dhe u ktheva në Kosovë më 1943, sepse i afrohej lufta terri-torit të Italisë. Disa shokë të mi shqiptarë, pas kësaj kohe të kaluar në Itali, u kthyen në Kosovë pa dhënë asnjë provim, siç thotë fjala popullore - "Shko e eja, si Adem Peja". Por, si thash, falë Seminarit e Gjimnazit, ku kam kaluar tetë vjet, kam mësuar shumë gjëra të dobishme, të cilat i kam shfrytë-zuar gjatë gjithë jetës - shprehinë e punës, njëfarë disipline perso-nale në jetën e përditshme, dhe përvojën në shumë probleme e kthesa të rrezikshme në periudha të ndryshme. Edhe tash kam respekt ndaj drejtorit të seminarit, të ndjerit Dom Branko Dorçiqit, prift dhe inxhinier nga Istria, ndaj disa profesorëve të gjimnazit, siç i përmenda më parë, por edhe ndaj drejtorit të Gjimnazit, Radomir Ivanoviq, i cili ka qenë shumë rigoroz, por mjaft objektiv dhe i drejtë. Madje, ai më vonë pat shkruar në një revistë shkencore në Akademinë e Shkencave Serbe në Beograd, edhe këtë fjalë, për-mbajtjen e së cilës po e parafrazoj ashtu siç më kujtohet - "Vetëm falë kujdesit dhe mbrojtjes së shqiptarëve të kishave ortodokse serbe në Kosovë gjatë shekujve, sot i kemi të ruajtura e të padëm-tuara ato kisha".

Në robërinë sllave e greke mund të shkruhet e të flitet vetëm në gjuhën e Ezopit

Shumëkush ka menduar se jeni një poet vetëm për fëmijë. Por duke analizuar poezinë tuaj edhe për të

rritur, librin "Jehona e kohës", nga këndvështrimi i sotëm, shihet se poezitë tuaja kanë porosi shumë të lartë. Pasi tani më në fund, jetojmë në liri, a mund të na tregoni ndonjë strofë ku keni përdorë simbolikën?

M. Krasniqi: Siç dihet, ne shqiptarët kemi qenë në kohën e Jugosllavisë gjithnjë në shtëpi-në tonë të robëruar nga Serbia, pa kurrfarë të drejtash njerëzo-re, humane, lere më ato politike e kombëtare. Prandaj edhe ato pak fjalë që mund t'i belbëzonte ndonjë intelektual i rrallë për të drejtat tona, duhej t'i formulonte e t'i shprehte në gjuhën e Ezo-pit, në mënyrë figurative. Kështu edhe unë, në "kohën e kralit" e kam shkruar dhe botuar në fle-tushkën e nxënësve "Hylli" më 1939 një vjershë me titull "Drintit të Bardhë", ku janë edhe këto 2 strofa:

"Dri i Bardhë, ujë i bekue,
Pse po shkon gjithë
tue gjimue?
Uji yt turbull pse shkon,
Çka ke Dri, që kështu vajton?
.....
Unë po t'pves e ti s'ban za,
Tue gjimue shkon pa pra.
Heshtjen tande e kuptoj,
Kqaj pra Dri, dënesët
shpeshtoi!....

Gjithashtu në atë kohë ro-bërie, si nxënës i gjimnazit në Prizren, kam shkruar vjershën "Dialog me bylbylin", ku janë edhe këto strofa -

"O bylbyl i vogël,
A di me më kallxue
Çfarë ilaci mundet
Mue me m'pshtue?
.....

Veç era e një lulje
Mundet me t' shëruet.
Pra mundou sa t'mundesh
Shejpt më fitue.

Ajo lulë e bukur

“ Në realitet në Prizren ne seminaristët kishim dy shkolla: në Seminarin katolik - disiplinë e mësim individual, edukatë qytetare e fetare, kurse në gjimnazin shtetëror - mësim rigoroz. Megjithëse qëllimi i seminarit ishte vazhdimi i shkollimit në teologji, askush nuk bënte presion që të ndiqet kjo rrugë, kështu që as vetë nuk shkova në Kroaci në teologji, po në Itali, me bursën që ua dha ministri i arsimit Ernest Koliqi të gjithë maturantëve kosovarë. Unë në Universitetin e Padovës, në Fakultetin filozofik, studiova letërsinë dy vjet. ”

E ka emnin Liri,
Gjindet n' maje t' bjeshkës
Dhe ashtë kuq e zi....

Kjo vjershë këndohej nga po-pulli në manifestimet e shumta më 1941, sipas melodisë së kë-ngës popullore maqedone "Pi-letu mi poje", dhe është botuar në librin e IV të kompletit tim "Qëndrime e reagime", Prishti-në, 1995, f. 304. Në përmbledhjen e poezive të mia për të rritur "Je-hona e kohës", Prishtinë 2006, një vjershë alegorike ka titullin "Përralla e vjetër", në të flitet për "maharaxhen" - një sundimtar i egër rajonal në Indi, i cili këtu ka kuptimin e regjimit të Beogradit në Kosovë. Në një strofë të saj thuhet:

"Maharaxha ishte shumë
zemëri,
Katil i lindur, tepër dinak.
Populli e urrente, e kishte
mendit,
Madje, as qentë s'e donin
aspak!

Në kohën e "mareshalit" kam botuar disa libra poezish për fëmijë, ndër të cilat edhe "Përrallat e gjyshit", më 1953, ku ka shumë vjersha alegorike, si p.sh. "Ujku e kingji", ku janë edhe këto vargje -

"I vogli prej t'madhit
gjithmonë asht në rrezik,
delja kurr nuk muji ujku
më ba mik!....

Shqiptarët e dinë mirë kush është delja e kush është ujku!

Universiteti në Prishtinë - burim i kuadrove profesionale

Ju jeni ndër profesorët e parë të Universitetit të Prishtinës, fillimet e këtij Universiteti, vështirësitë me të cilat është ballafaquar gjatë kohës, rëndësia e tij?

M. Krasniqi: Megjithëse në Jugosllavinë socialiste minori-tetet etnike fituan disa të drejta, prapë ekzistonin disa grupe dhe individë që kundërshtonin për-parimin e tyre. Kështu ka ngjarë me disa fakultete edhe me Uni-versitetin e Prishtinës. Kundër-shtarët e hapjes së tij merrnin si argument problemin financiar, atë të kuadrove, nivelin kulturor në Kosovë, mungesën e traditës etj. Por argumentet tona ishin më bindëse, më të arsyeshme dhe më në fund u hap Univer-siteti më 1970 me disa fakultete. Është e vërtetë se në fillim ne na mungonin kuadrot profesiona-le, por këtë problem e zgjidhëm me angazhimin e profesorëve nga Universiteti i Beogradit, Nishit, Shkupit e më vonë edhe të Tiranës. Me kohë krijuam dhe kuadrot tona të shkolluara në Beograd e Zagreb në studi-me postuniversitare. Në hapjen e fakulteteve dhe të Universite-tit na ka ndihmuar shumë rektor-i i Universitetit të Beogradit Prof. Dr. Dragisha Ivanoviq, i cili kishte titullin edhe të he-roit të popullit, me prejardhje ishte nga fisi Kuq i Malit të Zi, kështu që kishte simpati ndaj shqiptarëve.

Por problemeve të ndryshme rreth hapjes së Universitetit, iu shtua edhe problemi i rektorit të parë. Këtë problem e shtuam ne shqiptarët, sepse, si gjithmonë, ne e duam "kapuçin e madh", bajrakun, ballin e oxhakut. Nga një anë, Komiteti i Partisë Komuniste e kishte kandidatin e vet për rektor të parë të Uni-versitetit, mirëpo, nga ana tjetër, studentët e të gjitha fakulteteve dhe personeli administrativ, me këmbëngulje kërkonin që unë të jam rektor i parë. Madje, situa-ta u acarua aq sa studentët de-monstronin haptas në tubimet e tyre masive në salla të fakul-teteve dhe kërcënonin të dalin në rrugë të demonstrojnë. Unë vetë intervenova në tubimin e madh të tyre në amfiteatrin e

Fakultetit Juridik-Ekonomik, duke i bindur studentët se unë nuk kam kurrfarë pretendimi për postin e rektorit, se nuk ka rëndësi kush do të jetë sot rektor, por është me rëndësi që e kemi Universitetin dhe tash le të jetë rektor ai i cili ka për-krahjen e Komitetit, herën tje-tër do të jetë tjetërkush rektor e kështu me radhë. Unë edhe sikur të bëhesha sot rektor, nuk do të kisha mundësi ta kryej punën si duhet, sepse nuk do ta kisha përkrahjen e Komitetit e të pushtetit, sepse nuk jam as anëtar i Partisë, prandaj duhet ta përkrahim të gjithë kandida-tin tjetër, e jo mua. Kuptohet, puna përfundoi siç urdhëronte Komiteti komunist. Unë kam qenë gjithmonë në shënjestër të policisë dhe politikës shovinis-te serbe, kështu që më 1981 më përjashtuan edhe nga puna, me urdhrin e Komitetit të Partisë Komuniste, sepse nuk pranova të dal në mjete të informimit dhe t'i dënoja demonstratat e studentëve që u mbajtën në ato ditë. Policia serbe tërhoq nga libraritë të gjitha librat e mi, madje edhe tekstet e gjeografisë që kisha botuar për të tri nive-let e shkollimit. Këtu më duhet ta përmend përsëri reagimin e botuar në web-faqen "Iliria", ku ai ziliqari, shkruan për mua: "Makineria e Sigurimit serb ia bënte propagandën që studen-tët ta zgjedhin rektor të parë të Universitetit!"

Rëndësia e Universitetit të Prishtinës është shumë e ma-dhe, sepse ai vepron i pavarur nga të tjerët, hapë fakultete të reja sipas nevojës dhe krijon kushte të volitshme për studime kualitative, duke prodhuar kë-shtu ekspertë për shumë degë të jetës shoqërore, ekonomike, arsimore, shëndetësore, teknike, bujqësore etj. Universiteti është edhe një element i shtetësisë, ose të paktën një hap në këtë drejtim. (Vazhdon në nr. e ardh-shëm)

Katolicizmi në Prizren dhe rrethinë në shekuj

Sado që historiku i fillimeve të para të katolicizmit dhe rreth, si dhe për Ipeshkvinë e Prizrenit është i errët, megjithatë, mund të thuhet se kjo ipeshkvi është njëra prej më të vjetrat në trevën e Ballkanit. Nuk jemi larg të vërtetës nëse konstatojmë se kjo Ipeshkvi, pas shkatërrimit të Justinana Secunda, Ulpianës antike, gjatë dyndjeve barbare dhe ngulitjes së sllavëve në Ballkan, i mori ingerencat juridike dhe titulare të kësaj ipeshkvie.

■ SHKRUAN:
Prof. dr. Jahja DRANÇOLLI

Idhur me fillimet e katolicizmit në Prizren dhe rrethe, si dhe për Ipeshkvinë e Prizrenit është shumë vështirë të jepet ndonjë mendim i prerë, meqë të dhënat për këtë ipeshkvi janë paksa të errëta dhe kërkohet të bëhen kërkime të reja shkencore për këtë çështje. Mirëpo, sado që historiku i fillimeve të para të Ipeshkvisë së Prizrenit është i errët, megjithatë, mund të thuhet se kjo ipeshkvi është njëra prej më të vjetrat në trevën e Ballkanit. Nuk jemi larg të vërtetës nëse konstatojmë se kjo Ipeshkvi, pas shkatërrimit të Justinana Secunda, Ulpianës antike, gjatë dyndjeve barbare dhe ngulitjes së sllavëve në Ballkan, i mori ingerencat juridike dhe titulare të kësaj ipeshkvie.

Në fakt, edhe pse Ipeshkvia e Prizrenit përmendet në dokumentin e Bazilit II (1020), ruhen dëshmi të tërthorta se kjo ipeshkvi përmendet që në vitin 458, që ndërlidhet me Koncilin e Kalcedonit. Çështje e vërteta, në letrën dërguar perandorit Leon, në mesin e ipeshkvijve të tjerë përmendet edhe Pali, ipeshkëv i Prinatenus-it "Paulus episcopus Prinatenus". Autori i veprës monumentale *Illyricum Sacrum*, Daniele Farlati, këtë qendër e identifikon me Prizrenin.


Gjatë kohës së sundimit bullgar të mbretit Simeon (893-971), Ipeshkvia e Prizrenit do të gjendet nën juridiksionin e Patriarkanës bullgare. Pas vitit 971, me rënien e Perandorisë Bullgare, territori i Ipeshkvisë së Prizrenit i takonte Patriarkanës së Kostandinopojës (Bizantit) deri më 976. Ndërkaq, me formimin e Perandorisë së Samuilut dhe gje-

rë më 1018, areali në fjalë i takonte juridiksionit të Mitropolisë së Ohrit. Pas rënies së Perandorisë së Samuilut më 1018, territori i Prizrenit ra përsëri nën sundimin bizantin. Ndërkaq, perandori bizantin Bazili II, Patriarkanën e Ohrit e zbriti në rangun e mitropolisë, por ia la pavarësinë mbi 31 ipeshkëvi. Në akt dhuratat e viteve 1019, 1020 dhe 1025 lëshuar në dobi të Kryepeshkopatës së Ohrit, në mesin e ipeshkvijve, bënte

pjesë edhe Ipeshkvia e Prizrenit. Ipeshkvia e Prizrenit është përmendur në akt dhuratën e vitit 1019. Së këtijmi, për ipeshkëvitë e Kosovës thuhet: "[...] dhe peshkopin e Prizrenit në vetë Prizrenin, Hoznë (Hvosne-J. D.) [...] me gjithsej 15 klerikë... dhe peshkopin e Lipenit (Lipjanit) në enoritë (famullitë) e tij të ketë 15 klerikë". Në këtë kuadër Ipeshkvia e Prizrenit ishte e rangut të tretë me seli në kishën e Shën Prenës. Përveç

Prizrenit me rrethinë hynin edhe territoret e Hvosnës, rrethet e Pejës dhe Deçanit. Në kartën e Stefan Deçanit thuhet se kisha e Shën Prenës ka ekzistuar që nga kohërat e "mbretërve të moçëm". Ndërkaq, gjatë viteve 1197-1207, u pushtuan shumë toka arbërore, midis të cilave përmendet edhe Shkupi, Prizreni, Tivari. Po në këtë kohë mësojmë edhe për emrin e ipeshkëvit të atëherëshëm të Prizrenit, Abrahamit,

i cili së bashku me ipeshkvijtë tjerë të Shkupit, Nishit etj. nënshkroi letrën, të cilën ia dërguan më 1204 Papës Inoçenti III. Pra, nga kjo e dhënë, kuptojmë se Ipeshkvia e Prizrenit në fillim të shek. XIII, hyri në kuadër të Patriarkanës bullgare të Tërnovës, e cila në atë kohë e kishte pranuar supremacinë e Papës së Romës. Në vitin 1207, Ipeshkvia e Prizrenit, Shkupi, dhe disa të tjera, u gjenden përsëri nën



Kisha e Shën Nikollës në Velezhë

Kryepeshkopatën e Ohrit. Nuk e dimë ende se sa zgjati kjo gjendje dhe ç'ndodhi me ipeshkëvin *Abraham*, por dihet se Prizreni në gjysmën e parë të shek. XIII u pushtua nga nemanjidët.

Pas pushtimit të Prizrenit nga nemanjidët, kryepeshkopi Sava më 1219 nga Ipeshkvia e Prizrenit, shkëputi një pjesë të territorit të saj duke themeluar Ipeshkvin e Hvosnës me qendër në manastirin e Studenicës. Natyrisht, se pas pavarësimit të kishës nemanjide, nga Kryepeshkopata e Ohrit më 1219, përgjithësisht për kishën arbërore të Kosovës nisi mynzyra e kishës katolike. Kjo gjendje u ndie sidomos në Ipeshkvinë e Prizrenit, ku Kryepeshkopi Sava vendosi një peshkop serb. Ky veprim provohet nga letrat protestuese të Kryepeshkopit të Ohrit, Dhimitër Homatijanit në vitin 1220, të dërguara në adresë Savës, ku theksohet se Sava: "*me dhunë e largoi ipeshkvin e Prizrenit duke vendosur një tjetër që ishte i përshkrahur për të*". Po, në këto letra, e Dhimitër Homatijani shprehte mospajtime me themelimin e Kryepeshkopatës autoqefale serbe. Letrat e Dhimitër Homatijanit paraqesin burim themelor që i referohen për Ipeshkvisë së Rashës dhe të Prizrenit gjatë kohës së riorganizimit të kishës serbe nga Kryepeshkopi Sava. Nga një dokument ku përmendet numri i peshkopatave të Kryepeshkopatës serbe deri më 1220, numërohen tetë peshkopata. Në kuadrin e tyre nuk përmendet Ipeshkvia e Prizrenit as e Lipjanit. Sipas këtyre të dhënave, shrohet çështja se a ishin pjesë përbërëse të kishës serbe në vitin 1220 Ipeshkvia e Prizrenit dhe Lipjanit. Sipas mendimit tonë kisha autoqefale serbe në vitin 1220 zotëronte 8 peshkopata. Ndërkaq, në vargun e tyre nuk bënin pjesë Ipeshkvia e Prizrenit dhe e Lipjanit.

Titullarët e Ipeshkvisë së Prizrenit janë të njohur gjatë shekujve XI, XII e sidomos prej shekullit XIII. Në të vërtetë, në letërën e Papës Inocentit IV, që mban datën e vitit 1253 në mesin e sufraganeve të Argjipeshkvisë së Tivarit përmendet edhe ipeshkvijtë e Prizrenit (ndonëse emrat e tyre nuk na janë të njohur), kurse në shek. XIV përmenden pesë ipeshkvij: Konradi (1313-1320), anëtar i urdhrit dominikan, Benedikti (1335-1338), Gjoni (vdiq më 1363), Robertus (1350-1375), Gjoni II (1375) dhe Gulielmus. Se a është fjala për Ipeshkvinë e Prizrenit e jo të Prishtinës apo ndonjë tjetër kemi të dhëna të sakta të kësaj kohe. Pas përmendjes së ipeshkvit të Prizrenit, Abrahamit në letërën e dërguar Papës Inocentit III në vitin 1204, ipeshkvijtë

e tjerë që i përmend studiuesi Eubel deri më 1363 nuk mund të konstatohen se a janë ata me siguri (Pissinensis, Pristinensis). Në vitin 1375, në librat noterisë së Raguzës përmendet "*gos dimisit frater Johannes episcopus Prizrenensis*". Është për tu theksuar se në vitin 1363, pas vdekjes së njëfarë Gjoni, ipeshkvit të Prizrenit, Papa Urbani V e emëron për ipeshkëv Robertin. Pasardhësi i Robertit ka të ngjarë se ishte Gjoni II. Nga letrat e Papëve gjatë shekujve XIV dhe XV shihet se Ipeshkvia e Prizrenit ka qenë sufragane e Ipeshkvisë së Kotorrit.

Një lajm tjetër me interes lidhur me Ipeshkvinë e Prizrenit është ai i Papës Bonifacit IX, i cili në vitin 1404 e emëron dominikanin Gjergj Panduzi, ipeshkëv të ipeshkvijve të bashkuara kanonike "*Priscens et Bendenis*". Nga letra e Papës kuptojmë se paraardhësi i Panduzit, ishte ipeshkvi Andrea, i cili në vitin 1387 mori mbi vete obligimin e pagimit të takses së rëndomtë me rastin e marrjes së bulës papnore. Pas ipeshkvit Gjergj Panduzi,

nuk e përfaqëson islamizmin për shkak të bindjes religjioze por, në radhë të parë, për shkak të arsyeve politike dhe ekonomike. Se çfarë ka qenë pozita e krishterëve shqiptarë nën sundimin turk mjafton të lexohen relacionet e vizitorëve papnorë. Mirëpo, edhe mungesa e klerit dhe formimi i tij i dobët intelektual dhe fetar, ka mundësuar përhapjen e islamizmit. Nga të dhënat që na i sjellin relatorët, shohim se kleri, jo vetëm që nuk ishte përgjigjur me vepra thirrjes së vet, por ka pasur edhe të tillë që as që kanë ditur të shkruajnë e të lexojnë.

Mirëpo, me themelimin e Kongregatës "Propaganda Fide" (1622) fillon rivendosja dhe riaktivizimi i klerit dhe hierarkisë së Kishës Katolike shqiptare. Në ripërtëritjen e hierarkisë së Kishës Katolike, edukimit dhe arsimimit të klerit në përgjithësi, përveç "Propagandës Fide" rol të rëndësishëm ka luajtur Kolegji Urban dhe Ilirik në Loreto më 1627 dhe Ilirik në Fermo më 1631, si dhe misionet italiane françeskanë më 1634. Së këtejmi, ripërtëritet Ipeshkvia e Prizrenit dhe

Shkupit. Argjipeshkvi i fundit i Ohrit kishte rezidencën në Prizren. Me këtë bashkim personal shuhet dioqea e Prizrenit dhe rolin e argjipeshkvit të Tivarit e merr argjipeshkvi i Shkupit.

Përkundër përndjekjeve, Kisha katolike shqiptare në shekullin e XVIII ringjallet, e merr veten në duar të veta. Këtu shihet edhe dora e Provanisë Hyjnore. Në këtë kohë e kemi edhe ngritjen në Seli papnore të Klementit XI, përkatësisht Gjoni Françesk Albanin, papë shqiptar. Identitetin e tij shqiptar e pohan edhe Papa Pali VI, në letërën e tij të botuar më 17 janar 1968, në Romë me rastin e kremtimit të 500-vjetorit të vdekjes së fatosit kombëtar, Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.

Shekulli XIX dallohet për nga një farë lirie të Kishës Katolike, në radhë të parë, në saje të fuqive të mëdha e sidomos të Austrohungarisë, e cila e konsideronte veten si trashëgimtare të Venedikut në Shqipëri. Nga ana tjetër forcohet edhe ndihma materiale e klerit, veprimtaria e tij në fushën e fesë dhe formimi i tij i shkëlqyeshëm intelektual

rimtaria e Kishës ballafaqohet me vështirësi të mëdha, mirëpo kleri katolik formohet kryesisht në Shkodër dhe priftërinjtë përveç veprimtarisë pastorale merren edhe me arsim. Së këtejmi edhe në famullinë e Prizrenit vepronin shkollat në gjuhë shqipe.

Në fillimet e shekullit XX, përkatësisht deri më 1914, Kisha e Shkup-Prizrenit quhet Argjipeshkvia Shkup-Prizren. Është e njohur se rezidenca ipeshkvnore gjatë viteve 1821-1934 ka qenë në Prizren dhe më pastaj kalon në Shkup. Mirëpo, Selia e Shenjtë me Aktin nr. CXXXIII të datës 2. X. 1969 bënë riorganizimin kishtar. Me këtë Akt ripërtëritet Ipeshkvia e dikurshme e Prizrenit, kështu që e tërë dioqea quhet me emrin e ri: Ipeshkvia Shkup-Prizren. Kjo përfshinte si edhe më parë Maqedoninë, Kosovën dhe Sanxhakun. Me ripërtëritjen e Ipeshkvisë së Prizrenit më 1969 për komunitetin e katolikëve shqiptarë emërohet Imzot Nikë Prela për ipeshkëv ndihmës apo "sedi datus", kurse për ipeshkëv të Ipeshkvisë Shkup-Prizren më 2. X. 1969 emërohet Imzot Joakim Herbut, i cili intronizohet në Ferizaj më 3. I. 1970, ndërkaq Imzot Nikë Prela më 6. I. 1970 në Prizren.

Me ardhjen e ipeshkvit shqiptar edhe me përformimin e numrit të meshtarëve shqiptarë ndihet një gjallëri si në jetën shpirtërore ashtu edhe në veprimtarinë intelektuale-botuese. Më 1. III. 1970 në Prizren doli revista fetare-kulturore "Drita". Ky organ me ndërprerje të shkurtra del edhe sot. Nga viti 1970 deri në ditët e sotme Ipeshkvia e Prizrenit ka botuar edhe shumë botime të veçanta të karakterit fetar, kulturor e shkencor, të cilat e begatojnë jo vetëm jetën fetare por edhe atë kulturo-shkencore.

Përkundër të gjitha të arriturave të përmendura, duhet të theksojmë

se dioqea e Prizrenit ende nuk ka marrë fizionomi të përkryer. Shumicës së famullive ende u mungojnë objektet themelore për kryerjen normale të aktivitetve fetare. Megjithatë duhet thënë se edhe në këtë aspekt është arritur mjaftë. Këto ditë ka nisur edhe ndërtimi i katedrales Nëna Terezë në Prishtinë.

Duke përmbyllur kumtesën, mua më pëlqen t'i citojë fjalët largëvajtëse të Dom Gaspër Gjinit, i cili thoshte: "*Jetëjme me plotë shpresa se ardhmëria do ta plotësojë krejt atë që na kanë marrë shkuajt*".

(Vërejtje: Kumtesë e mbajtur në famullinë e Velezhës, Prizren, më 15 shtator 2007, me rastin shkurimit të Kishës dhe 50 vjetorin e bekimit të gurtëmelit.)

“ Edhe pse Ipeshkvia e Prizrenit përmendet në dokumentin e Bazilit II (1020), ruhen dëshmi të tërthorta se kjo ipeshkvi përmendet që në vitin 458, që ndërlidhet me Koncilin e Kalcedonit. Çështje e vërteta, në letërën dërguar perandorit Leon, në mesin e ipeshkvijve të tjerë përmendet edhe Pali, ipeshkëv i Prinatenus-it "*Paulus episcopus Prinatenus*". Autori i veprës monumentale *Illyricum Sacrum*, Daniele Farlati, këtë qendër e identifikon me Prizrenin. ”

selia e ipeshkvisë mbeti e zbrazët dhe nuk përmendet më asnjë ipeshkëv për dy shekuj me radhë. Ndonëse Ipeshkvia si e tillë nuk përmendet me ipeshkëv, prapëseprapë Ipeshkvia si e tillë nuk shuhet, meqë më 1618 përmendet ipeshkëvi, Pjetër Katiqi. Kuptohet se ndërprerja e vazhdimësisë se titullarëve të kësaj ipeshkvie dëshmon qartë për vështirësitë e kohës, e në rëndë të parë për besimtarët katolik. Pikërisht për Ipeshkvinë e Prizrenit, në dokumentin e Papës theksohet se kjo Ipeshkvi gjendet në regionin e jo të pafeve "*In partibus infidelium*" dhe se janë pa bariun e vetë. Pas pushtimit turk, kisha e Prizrenit është sufragane e Argjipeshkvisë së Tivarit. Në kushte të krijuar nga popullata e trevës së Prizrenit

më 1618, Papa Pali V për ipeshkëv e emëron Pjetër Katiqin, i cili ishte sufragani i Argjipeshkvisë së Tivarit. Më 1624 për ipeshkëv të Ipeshkvisë së Prizrenit emërohet Pjetër Mazreku, prizenas, i cili pas pak kohe emërohet argjipeshkëvi i Tivarit dhe primas i Serbisë. Në vitin 1651 "Propaganda Fide" e emëron Ndre Bogdanin për argjipeshkëv të Ohrit. Në ndërkohë i lejohet që të qendrojë në Janjevë dhe Prishtinë. Por në mungesë të prelatëve ky prej vitit 1666 nga Propaganda Fide autorizohet që t'i administrojë të gjitha katedrat vakante ipeshkvnore në Serbi. Në kohën e Ndre Bogdanit bëhet bashkimi i Argjipeshkvisë së Ohrit dhe Ipeshkvisë së Shkupit, si dhe të Ipeshkvisë së Prizrenit dhe të

e shpirtëror. Edhe pse sipas reformave turke më 1839 njëjhe shprehja e lirë e besimit në tërë Perandorinë turke, në Kosovë nisi të zbatohet më 1843. Mirëpo, për shqiptarët katolikë nuk ndryshoi fort situata. Kur 25 familje laramane të Stubllës, Binçës, Vernakollës, Terzajave, dhe të Karadakut u shprehën haptazi se janë të krishterë, pashai i Gjilanit më 1846i internoi në Anadoll. Megjithatë, është e njohur se "gjaku i martirëve është fara e të krishterëve!" Kjo çështje ilustron se miri me rastin e famullitarit të Prizrenit Dom Gaspër Krasniqit, i cili në Letnicë i shpalli 32 familje laramane për katolikë.

Sa i përket Argjipeshkvisë së Shkupit me seli në Prizren vep-

shpalosje

Ku rreh kambana – aty është paqja

■ SHKRUAN:
Nikollë KËRHANAJ

Duke shfletuar dokumente nga arkivat, raporte ndërkishitare e të Ipeshkvive. Libra të Amzave të Lindurve, të Kurorëzimeve, të Vdekurve e materiale tjera të botuara e të pabotuara, më ra në dorë të lexojë ndër shumë emra vendesh edhe Rugovën e Pejës me fshatrat përreth si dhe fshatrat e Malishevës, si Karavansarinë, Nishorin, Semetishtin e fshatra tjera me të cilat banorët e Zymit kishin bërë krushqi e marrëdhënie miqësore me banorët e famullive të tyre.

Krahas këtyre shënimeve të vjetra që kisha në dorë, mora edhe një tubë shkrimesh e publikimesh nga gazetaret e përditshme e periodikë të ndryshëm që botohen në Kosovë, sidomos për ndërtimin e kishës në Kuqishtë (2005) dhe atë në Karavansari të Malishevës (2006).

Fati në fatkeqësi

Nga historia e përgjithshme e në veçanti nga historiku i kishave është i njohur konflikti i fuqive të mëdha dhe si pasojë e luftërave ruso-turke, në vitin 1702 u dëmtua Katedralja Katolike shqiptare në Shkup, njëkohësisht edhe rezidenca Ipeshkvore. Në kushte pasigurie e në rrethana lufte Imzot Pjetër Karaxhiqi, kryepeshkëvi i Ipeshkvisë Shkup-Prizren mbetet nën qiellin e hapur. Pa humbur kohë në atë vit (1702) vije në Prizren, Novobërdë (Artanë, ku ishte vendlindja e tij) e Janjevë. Duke i shqyrtuar rrethanat shoqërore, politike e fetare P. Karaxhiqi ishte përcaktuar dhe kishte zgjedhur rezidencën e vet në Famullinë e Zymit – Misionin e Hasit. E kishte bërë këtë si vendstrehim më i qetë, më i sigurt dhe në cilësinë e një vendi më të shenjtë që mund të ekzistojë aso kohë.

Dhe, këtë vendim të rëndësishëm mund ta përmbledhim e ta shprehim me një sentence meditative – "Fati në fatkeqësi".

Zymi – strehimore ipeshkvnore

Realisht thënë, vendosja e Imzot Karaxhiqit në Zym, të zgjedhur për vendstrehim, nën patronin e Shën Mërisë, do të vazhdojë për 50-vjet me radhë me kryepeshkvinjtë të cilët pasojnë, si: Imzot

Pjetër Karaxhiqi, nga viti 1702 deri më 1727 (vdiq më 15 janar 1727 dhe u varros në Zym), Imzot Mikel Suma nga viti 1727 deri më 1743, Imzot Gjon Nikollë Kazazi nga viti 1743 deri më 1752 dhe Imzot Toma Tomićiq nga viti 1753 deri më 1758.

Famullia e Rugovës, misionarët dhe qëndresa

I përmenda këta kryepeshkvinj sepse udhëhiqnin të gjitha famullitë e Dukagjinit në mes të të cilave edhe Pejën e Rugovën me filialet e fshatrave përreth, për të lënë gjurmë jete e lashtësie.

Veprimtarinë në kishat e përmendura e në filialet e tyre e zhvilluan këta meshtarë: Don Mark Bardhi (cili shërbente në Zym për misionin e Hasit, para vitit 1700), Don Andrej Braciani, Don Pjetër Bytyçi me ndihmësin Don Nikollë Spani, Don Pjetër Pietrarossa (i lindur në Pejë), Don Ivan (Gjon) Logoreci, Don Josip Berisha, Atë Augustini prej Civitella, Atë Dominik Tadesko, Atë Antoni prej Monte Mura, Atë Josipi prej Pedone, Atë Karlo

prej Kaprine, Atë Ludeviku prej Kaprine, Atë Dominiku prej Venediku, Atë Petar Romano prej Vicovaro (nga rrethi i Romës, i cili vdiq nga mundimet e vështirësitë jetësore, dhe vuajtjet nga pushteti osmanli vetëm për të ruajtur fenë). Nga këto mundime edhe Imzot Pjetër Karaxhiqi vuajti, u sëmur dhe ndejti në krevat plot 14 muaj (në Zym). Atë Pjetri prej Vicovara, Atë Rafaelli prej Napulja, Atë Karlo prej Caprina, Atë Franjo prej Millanos, Atë Franjo prej Laura, Atë Josip Nika prej Pedane (Shqipëri), Atë Josip Marija d'Urbania, Atë Karlo prej Montefortino (në misionin e mjekut) Don Ambroz Bosco, Don Pavle (Pali) Zogani (Zogaj), Don Andrej Krasniqi, Don Ivan Berisha e ndonjë tjetër.

Që të gjithë, rreth 30 meshtarë (edhe kryepeshkvi Matej Mazreku) punonin me përkushtim të madh në shërbimet e ceremonive fetare edhe përkundër dhunës së Pashës së Pejës në Pejë, Rugovë të Pejës (me filialet e saj në, Bogaj, Kuqishtë e gjetiu), në Peshter, Drenicë, Rozhajë, Kolashin,

Çiçavicë, Plavë e Guci, duke kaluar kufinj të Kosovës, në pjesët e Shqipërisë e të Serbisë, sepse feja nuk njih kufij politik.

Pasha i Pejës u kishte dhënë leje për t'i kryer ceremonitë fetare-katolike në Pejë, Rugovë, Peshter e në filialet e tyre vetëm dy priftërinjë dhe këtyre: Don Mark Bardhit (i cili shërbente në Zym) dhe Don Andrejes prej Novi Pazarit. Po ashtu, kohë pas kohe lejonte edhe Don Ivan Preniqin, misionar nga Janjeva për t'iu ndarë sakramentet besimtarëve të këtyre vendeve.

A bsolutisht, Pasha i Pejës nuk lejonte realizimin e ceremonive fetare, pa pëlqimin e tij, as në kishë, as ndër familje katolike


dhe se nga kjo gjendje, priftërinjtë të ngushtuar e me ndjenja të ndrydhura shpirtërore, po ashtu edhe besimtarët qenë ngushtuar t'i largohen besimit të deriatë-hershëm në mënyrë spontane e gradualisht të konvertohen në besimin islam nga përndjekjet shtypjet e përdhunimet e papara në bashkëpunim me fenë ortodokse serbe në Pejë e kodo tjetër, që veronin në dëm të pjesëtarëve të besimit katolikë.

Përkundër presioneve, po t'i analizojmë rrugëtimet e vështira përmbi 5-6 orë udhëtimi nëpër rrugë të vështira, nëpër male të pakalueshme ndër fshatrat e Rugovës së Pejës, mungesën e banesave ndër kisha, munge-

Meditim

Përderisa në Kosovë po lind një pranverë e re për jetën e ardhme, andaj edhe duhet të gufojnë lule të reja me ngjyra të ndryshme për t'u begatuar vendi dhe njëherësh edhe për t'u përcaktuar identiteti shpirtëror. Për këtë, të pyesim vetveten: Përse të bëjmë jetë të dyfishtë fetare, kur mund të jemi të lirë ta shprehim identitetin tone shpirtëror pa droje kur jem të një gjaku e një gjuhe.

Të dhënat historike tek ne kanë mbetur kryesisht – ato gojore, e përse edhe jo të shkruara (?) Të analizojmë vetëm një publikim të "Novost-it" (2007) me titull "Srbska duhovna baština na Kosovo i Metohiji", përmes së cilës patriarku Pavle publikon një hartë toponomastike ku në mesin e 1.996 kishave serbe në Kosovë (siç thotë ai) shënon edhe një kishë dhe një shkollë serbe në Karavansari (?). Pyesim: a nuk është kjo një trillim i kulluar, kur populli autokton e njeh për kishë katolike shqiptare por në të kundërtën, ardhacaku e përvetëson dhe e kthen në kishë serbe? Si të demantohet kjo, përveç shënimeve të sakta me të dhëna faktografike.



Kisha në Kuqishtë të Rugovës

sën e mjeteve materiale, vuajtjet shpirtërore e fizike nga pushteti osmanli që ishte në fuqi e shumë peripeci tjera, e vlen, dhe në një masë shpaguehet mundi i tyre me ndërtimin e kishës së vogël në Kuqishtë, së pakut, siç shprehet populli, "hija" e të gjithë priftërinjve t'u pushojë pranë kishave, filialeve e kapelave ku kanë dhënë mundin dhe djersën e vet për këtë popullatë. Kjo është vetëm një përqindje e shpërblimit të mundit të tyre për qëndrësë e vetëflijim edhe, çka është më e keqja - deri në shpërngulje.

Kryepeshkvi Mihill (Mikel) Suma, së bashku me Kelmendasi të Malësisë së Madhe, të Rugovës e të tjerët u shpërngulën nga këto vise dhe u vendosën në Srijem në vendbanimet: Hërtovci, Nikinci, Jarak, Irig, Rumë, Mitrovicë të Sremit, në vitin 1771, të cilës shpërngule të madhe iu bashkua edhe Don Pal Zogaj, në cilësinë e mësuesit për gjuhë shqipe. Nxënësit e shkollës (shqipe) kaluan në Zagreb ndërsa M. Suma kaloi në Osijek, ku edhe vdiq në vitin 1777. Shpërnguljes së Madhe të kelmendasve nga Malësia e Madhe dhe Rugova iu kishte bashkangjitur edhe një familje zymjane, e cila vendoset në Nikinci të Sremit dhe regjistrohet në dokumentin nr. 246 të vitit 1782 në Gjakovë.

Po të shikojmë edhe në fushën e jetës shpirtërore dhe të vlerësojmë anën materiale-shpirtërore të banorëve dhe shtrirjen e tyre në pikëpamje gjeografike duke u ndarë në pikëpamje familjare, fetare e regionale, por edhe nga lidhja genealogjike do të konstatojmë se familjet Prenkpal-Kryezi gjenetikisht lidhen me Kelmendasi të Rugovës së Pejës ndërsa familjet e fshatit Shëngjergj të Zymit të Hasis, familjet Bytyçi janë vëllazëri, të një fisi e gjaku me familjet Bytyç-i në Karvansari, në Semetisht e në fshatrat tjera që mbajnë emrin Bytyç-i.

Për këtë, do të publikojmë disa të dhëna të marrëdhënieve farefisnore e miqësore të familjeve të Zymit që Zymi, herë pas here ka qenë i hapur në pikë-

pamje miqësore me trevat tjera shqiptare, megjithatë, here-herë i ka detyruar situata dhe rrethanat politike për t'u mbyllur në vetvete për çështje sigurie.

Në Amzat e të Lindurve në faqe 43, nr. rendor 5 në Zym, Ego Atë Albert Baptizani, më 28 gusht 1840, prindërit Simon Palushi dhe Marija prej KARVASARIOS, pagëzojnë vajzën me emrin Dila, me kumbarën Doçi i Mark Doçit dhe shoqja e tij - Dila nga Zymi.

Në vitin 1931, në librat civile, regjistrohet martesja e Ndue Çunit nga Karvanseri, të cilit pas një viti martese, në vitin 1932, u lind një fëmijë - djalë, me emrin Sebë. "Seba" fëmija i Ndue Islam Çunit, kumbar i të cilit ishte Kolë Zefi, bukëpjekës në Suharekë, që faktikisht është Kola i Zefit Rrafë Pecollajt nga Zymi, i cili asokohe ishte bukëpjekës në Suharekë prej nga kaloi në Gjakovë dhe shërbeu në kishën e "Shna Ndout".

Qiri i ndezur në qyp

Ndue Ndreke Kërhani (1903) nga Zymi, i dal në Kushavec (famullia e Bishtazhinit), me të birin, Frokun, në vitin 1949 në Gjakovë kishin kontraktuar blerjen e një grigje dhenësh nga një blegtor i Semetishtit të Malishevës dhe caktojnë ditën e marrjes së grigjës në familjen e tij (unë N. K. emrin ia kam harruar). Në ditën e caktuar shkojnë në Semetisht dhe i zoti i shtëpisë sipas zakoni i thërrret dhe i vendosë brenda në dhomën e miqve. Derisa këta bëjnë përshëndetjet e zakonshme, vërejnë një qyp, skaj oxhakut në pamje dekorit brenda të cilit dukej një shenjë drite?

Ndërkohë vjen i biri për të lajmëruar se dhentë (delet) janë gati dhe se mund të nisen. I biri, duke mos ditur se blerësit e deleve janë të përkatësishë katolike, e qorton babanë duke i thënë: pse je ka ban tym në dhomë (duke aluduar në qiriun e ndezur në qyp)? Baba i përgjigjet: Kjo asht feja e vjetër dhe ky asht qiri i Shinkollit të cilit shenjt deri sa t'jam gjallë, unë gjithmonë do t'ia ndezi qiriun.



Këmbana në oborrin e kishës në Dugujevë

Meditim për shekullin tonë

Aty dhe atje ku nuk hyri Krishti

Ndoshta një ditë do të dëshmohej prania e kryqit, më parë se gjetiu, tek illëret... Andaj, pse të mos pohojmë: herët u ngrëthye në shpirtitrat e paraardhësve tanë simboli i urtisë, mirësisë e flijimit njerëzor - Jezu Krishti e krishterimi. Aq sa dimë, themi, jo vetëm u përqafua, por për vazhdimësinë ilire u bë bartës dhe frymëpërcues i rregullave të krishterimit, qoftë përmes Shën Palit, Shën Jeronimit, Shën Albanit e apostujve tjerë, që emblemtohen në ikonografinë e krishterë, në ngrehina e objekte kulturi, të shumtat të rrënuara nga barbaria e lashtë dhe e vonshme.

Mandej, gjithë duke vijuar në kapërcëjtë e kthesa epokale të njerëzimit:

edhe shenjtërit tanë ngrëthyen e zbërthyen frymën e shenjtë për ndriçimin e udhës nga do të ecte njeriu.

Shmangien e shpëtimin nga mëkatet në jetën fizike e shpirtërore dhe përgatitjen për mirësi, mëshirë e paqe, gjithnjë për të ushqyer te njerëzit besim e përshtirërinë, për udhë të dinjitetshme, të amshuar, drejt ringjalljes në shpirtitrat e trupat të tjerë, sikur ringjallja e Krishtit...

Lakmia për troje, burime, pasuri e pushtet, për luks mbi gjakun e djersën e tjerëve, gjakimi ephshor, terratisën mendjet njerëzore, aq sa shpion në përplasje e dallgëzime të ashpra, tragjedish të egra e të pakuptimta me viktima gjithfarë-

she, kësajsoj mëkatet mbuluan breza të tërë...

Virusi i së keqes vijoi për të sëmure koka timonierësh për vendosje të ligshmërisë së tiranisë, absolutizmit e despotizmit: përplasjet qindvjeçare, kryqëzatat, luftërat botërore e lokale, terrorizmat klasikë e të sofistikuar! Atëbotë, në shpirtitrat e prijësve, dajjtë kishin kryqëzuar e rikryqëzuar për miliona herë shëmbëllesat të Jezusit.

Mjerisht, edhe sot njeriu ende nuk është larë plotësisht nga mëkatet që i bëri e po i bën Njeriut. Dhe Fryma e Krishtit vazhdon flijimin e pleksur në pasuesit e devotshmërisë së Tij. Aty ku mungon ajo frymë devotshmërie, aty, këtu

dhe atje ku nuk hyri Krishti, kurthëron djallit dhe në këmbëz gishtit...

Edhe në kapërcëll të mijëvjeçarit të dytë fryma e shenjtëve ringjallet ndër ne, për t'i dhënë botës sublimen e përvujtërisë, mirësisë e flijimit, stërmbesën e Gjergj Kastriotit, Gonxhen tonë, që bota e quajti Nënë, shenjtëreshën e ditëve tona - Nënë Tereze.

Pikërisht, atëherë kur njeriu filloi ta harronte njeriun, Zoti ia dhuroi botës "Mesinë" e bamirësisë e të përvujtërisë njerëzore, të lumen Tereze.

Kjo është dhuntia e madhbësitë, një dhuratë e gjenisë sonë për gjininë njerëzore.

Mehmetali REXHEPI

Kompozimet e Ballatës me temë shpirtërore-begati e muzikës së shënjtë shqiptare

Perëndimorja në muzikën e Zeqirja Ballatës (I)

Zeqirja Ballata (1943) pa dyshim është njëri prej kompozitorëve më të njohur e më të kompletuar ndër krijuesit bashkëkohorë të muzikës shqiptare në Kosovë. Me krijimtarinë e vet, ai është i pranishëm që nga viti 1963. Veprat e këtij autori, i cili na solli në Kosovë ndër të parët frymën e muzikës bashkëkohore, janë ekzekutuar nga shumë qendra të njohura muzikore evropiane dhe botërore.

■ SHKRUAN:
Akil Mark KOCI / Londër

Muzika, si pjesë e arteve elitare, pos të tjerash sugjeron imazhin si veprim aludiv, si paraqitje e botës së brendshme. Për mendimin tim ajo duhet të jetë inkluzive e jo ekskluzive, pra eksplicite e jo implicite, sepse zotëron ritmin e brendshëm me një dendësi të narracionit epiko-lirik që nxjerr në pah përvoja krijuese e identitetit dhe e personalitetit të krijuesit brenda së cilës kemi tinguj jo fort të nuancuar si simbol i një lloj rebelimi muzikor përmes fiksionit emotiv dhe imagjnativ, si refleks shtytës në formimin e një marrëdhënieje të re në shprehjen muzikore të

Takimi i Z. Ballatës dhe metodat e reja në gjuhën muzikore

Për të shkruar për personalitetet të tilla poliedrike siç është Zeqirja Ballata, për kolegun e mikun tim, me të cilin kemi bashkëpunuar mbi 30 vjet për lartësimin jo vetëm të krijimtarisë muzikore, por edhe të asaj kulturore në përgjithësi, është mjaft vështirë, sepse që në start has në shumë të panjohura, si në aspektin krijues, ashtu edhe në aspektin e njohjes së veprimtarisë së tij të shumfisishtë si kompozitor, muzikolog, profesor shumëvjeçar në Fakultetin e Arteve, profesor përkatësisht këshilltar në liceun artistik në Maribor të Sllovenisë, organizator i jetës muzikore dhe autor i disa librave muzikorë. E, pra, kjo përbën sfidë, sidomos për ata që

cila shfaqet edhe si strukturë dhe e shpalos paradigmen e njeriut, krijuesit që qëndron jo vetëm në profesionalizmin e vërtetë, por edhe në konvergencat si afirmim, ecje drejt afimit dhe afirmimit të krijimtarisë muzikore, pse jo, edhe të jetës muzikore, e cila ka qenë në kuptimin konvencional metaforë dhe pasqyrë e gjendjes së njerëz në trojet tona.

Si sot më kujtohet kur e pata shkruar artikullin e parë për këtë krijues gjatë një vizite në Lubjanë dhe që botuar në "Zërin e Rinisë" të datës 10 tetor 1967. Aty pata theksuar se "Zeqirja Ballata është autor i disa veprave muzikore, që kanë një të shprehur bashkëkohore, tipike, interesante dhe karakteristike".

Ai, me krijimtarinë e vet dëshmoi se është krijues i spikatur dhe i përkushtuar me tërë qenien

gosi dhe tipari themelor i krijimtarisë së tij, janë qasjet e pandërprera në hulumtimin e tingullit të ri si procedim i dhuntisë, prirjeve, duke përfutur një muzikë të kohës siç ishte poetika muzikore e modernes dhe pasmodernes dhe në këtë mënyrë shprehu intonacione të reja në veprat e veta, çka përbente një metodë të pazakonshme në gjuhën muzikore e që në atë kohë po krijoheshin dhe kultivohej në Kosovë.

Zeqirja Ballata në fillim e me të edhe autori i këtyre rreshtave, të parët rrënuan konvencionet e muzikës tradicionale, e cila kultivohej nga ata pak kompozitorë që jetonin dhe vepronin në Kosovë, mirëpo shprehja e tij, e bazuar në arritje të shekullit të kaluar si avangardë, ishte para se gjithash mënyra jo vetëm e vrotimit original, por edhe shtjellim kuptimor në tërësinë e shprehjes muzikore që lëvrohej në atë kohë si tërësi qenësore, si element i sistemit mikro dhe makrostrukturor, si objekt estetik dhe artistik. Po të shfletojmë partiturat e tij, në thelb të tyre do të vërejmë optikën e qartë të aftësisë krijuese, bukurinë, larminë dhe rëndësinë e strukturave që trajton, por jo me akorde dhe harmoni të bollshme sikurse në të kaluarën dhe me vijimësi në estetike të tejkaluar, por me melodi, akorde, ritme domethënëse të një shprehjeje intensive, unikale, filigranike, si një metafizikë që nuk merret si realitet i shkëputur, por shndërrohet në një metaforë të pëlqeshme mbi bazën e perceptimeve të kompleksitetit modern si sintagma poetike muzikore.

Edhe në krijimtarinë e kritikës dhe eseistikës muzikore, në fokusin e observimeve të tij, Ballata ka shprehur identitetin e vet me një frazeologji të pasur muzikore si proces i komunikimit artistik, duke u paraqitur edhe si njohës i mirë i semantikës dhe i semiotikës muzikore si sistem dytësor, si themel i elementit parësor, jo vetëm i kësaj gjinie, por edhe i jetës muzikore në Kosovë. Këto dukuri nuk paraqesin vetëm ndjenjën e tij, por edhe vlerësimet profesionale përmes shkrimeve, me të cilat ka dhënë ndihmesë të çmuar në pasurimin e mendimit kritik. Me gjuhën e rrjedhshme, ai i është bashkangjitur një grupi të vogël

muzikologësh ndër ne, duke vlerësuar krijimtarinë dhe veprat e krijuesve në mënyrë realiste, duke i analizuar ato në shumë aspekte, jo përmes një kritike gazetareske, por nëpërmjet zbërthimeve muzikologjike, estetike, pse jo edhe filozofike, si paradigma shkencore duke i bërë jehonë thënies aq të njohur se "arti shijohet me ndjenja e perceptohet me shqisë".

Mund të ekzistojnë shumë opinione për veprimtarinë e tij të gjerë, por të gjitha mbarojnë me një vlerësim të përbashkët, sipas të cilit kompozitori Ballata paraqet një individualitet të veçantë krijues, që posedon një erudicion të gjerë, mirëpo për t'i kuptuar këto marrëdhënie ambivalente duhet terminologjikisht të kuptohen premiset, pra parakushtet e veprimtarisë së tij madhore, sepse në strukturën artistike të krijimtarisë së tij hasim një shtrirje të gjerë duke filluar që nga "Tradita", "Muzika e re", ajo "Moderne" dhe "Avantgarda" që shpalosin një veçori kuptimplotë dhe një hulumtum specifik. Pra, ky krijues i çmuar e solli muzikën e një fryme të re në një rreth kur muzika klasike ishte një fatamorganë, një nocion i pashkolluar, i padeshifruar, një emër kuptimi, një abstraksion, ku poenta kuptimore e saj ishte e huaj dhe një barrë e rëndë, e papërballueshme për mjedisin në të cilin u shfaq, për shkak të mendësisë së qëllimshme që ekzistonte në atë kohë si "dhuratë" e sundimit pesëshekullor osman në një atmosferë të konformizmit fillestar muzikor, edhe pse ajo me magjinë e vet tingëllon dhe depërton jo vetëm në qenien tonë, por, me variacionet e saj të shumta, qofshin lirike, apo dramatike, krijon përfytyrime dhe imazhe të patjetërsueshme.

Muzika e tij, si diskurs përmbajtësor i veprave të shumta, erdhi si freski, këngëzim që u imponua në një univers kulturor të muzikës klasike, kryesisht i pangritur, si një kohezion emocional, si dritë shprese dhe kërkim shtigjesh artistike të pafundme e të pashkelura të artit në një ambient të zymtë kosovar, në mesin e një pjese tejet të vogël të krijuesve që vepronin dhe krijonin me një shprehje të tejkaluar narrative, jo vetëm për nga forma, por edhe për nga struktura kompozicionale, si dhe prirjeve



Akil Koci, Lorenc Antoni, Zeqirja Ballata, Vincenc Gjini dhe Rafet Rudi

Ballatës. Për këtë arsye, ky autor paraqet një personalitet, i cili me krijimtarinë e tij të gjithëmbarshme muzikore, me një univers të gjerë muzikor, imponohet me një larmi veprash në të gjitha zhanret, përveç atyre skenike, krijues i veprave të perceptuara si vlera artistike dhe estetike dhe zë vend të merituar në krijimtarinë brenda universit kombëtar mbarëshqiptar.

për të parën herë takohen me të. Megjithatë, brenda këtij koncepti është kënaqësi e veçantë të shkruhet për këtë krijues, i cili mbart në vetvete trinomin artistik, sepse kjo gjithanshmëri e në veçanti angazhimi i tij artistik, ravijëzon boshlin e shumëllojshëm të veprimtarisë së tij të gjerë. Është kënaqësi dhe njëherazi detyrë qytetare, të dëshmosh për tërë këtë mori angazhimesh, e

e tij duke na pasqyruar me veprat e veta një mjeshtëri krijuese përmes përvijimit të një shprehjeje me përkushtim dhe me një qasje në angazhimin e gjithanshëm që është qenësore jo vetëm për krijimtarinë e tij të bollshme, por edhe për potencën artistike duke arritur të krijojë individualitetin krijues jo vetëm në muzikë, por edhe në fusha të ndryshme të kulturës, artit dhe shkencës. Lo-

e tendencave që ishin larg dhe jashtë trendeve muzikore.

Edhe pse jetonim në gjysmën e dytë të shekullit XX, shekullin e iluminizmit shkencor, artistik, kulturor e qytetëruës, shekull i arritjeve të shënuara në të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore, në të vërtetë në hapësirën e krijimtarisë muzikore në Kosovë e Metohi, siç quhej atëherë, niveli ishte i ulët dhe ajo "krijimtari", ka qenë me tipare kryekëput provinciale, diletante, amatorese, me të gjitha parametrat e të krijuarit naiv në kompleksitetin e gjërë dhe pa kurrfarë kritere estetikë dhe muzikologjike - dëshmi e ekzistencës së një province muzikore në një planet të largët, krahas rrjedhave moderne dhe të një zhvillimi që ishte në trevat e tjera të ish-Jugosllavisë, pjesë përbërëse e së cilës ishim edhe ne.

Pra, në tërësi Kosova e atëhershme, për sa i përket krijimtarisë, jo vetëm asaj muzikore, por edhe në shkencë dhe arte të tjera, paraqitej si një arkipelag i një gëtoje kulturore, të cilën qëllimisht e kishin sajuar sllavët në ish- Jugosllavi, sepse shteti obskurantist komunist i ashtuquajtur Jugosllavi jo vetëm që nuk përkrahte, por qëllimisht e me paramendim e pengonte zhvillimin e saj në këtë pjesë të saj, dhe kështu pengonte haptazi para syve të botës zhvillimin sadopak normal që është dashur ta praktikonte siç veprooi me popujt e tjerë, të cilët, gjithashtu, jo fort herët patën qenë në të njëjtën gjendje. Këtu kemi parasysh Republikën e Maqedonisë, të Malit të Zi dhe të Bosnjë- Hercegovinës. Jeta shkencore, kulturore dhe artistike në Kosovë kishte një rrjedhë krejt tjetër, vetëm e vetëm pse shteti i atëhershëm jugosllav nuk shkollonte kuadro të nevojshme qëllimisht, si domosdoshmëri për një ecuri sadopak normale, si popujt e tjerë të "vëllazëruar e të bashkuar". Pra, ardhja e disa krijuesve dhe e një krijese me potencë të madhe evolutive, siç ishte Zeqirja Ballata, kompozitor me vibrate të brendshme, me fuqi shprehëse të pasur në rezonanca të reja, por jo avangardiste dhe absurde, "hermetike dhe abstrakte", por të kuptueshme, me vizion dhe imazhe të identitetit hapësiror etnik shqiptar, të bazuara në arritjet më bashkëkohore, me vetëdije të plotë dhe i formësuar me ndijme artistike, krijues i një shprehjeje universale, ia doli mbanë të ravijëzojë në mënyrë të përgjithshme dhe përmblendhëse, në teori dhe në praktikë, lidhje në ato hapësira të zbrazëta si sferë në mes reale dhe abstrakte, si arketipe të soditjes përballë një anarkie të vrazhdë shtetërore që ishte e pranishme me zymtësi në qiellin muzikor kosovar. Ky erudit, i cili me punë të palodhshme riformuloi idiomën muzikore në bazë të parimeve më bashkëkohore të muzikës evropiane, bëri përpjekje që t'i kapërcente këto pengesa dhe të hynte në hullinë

e një jete artistike të mirëfilltë, në të njëjtin hap me kohën.

Zeqirja Ballata është krijues që një pjesë të jetës e kaloi në mërgim si student dhe hulumtues në një qendër jashtëzakonisht të pasur muzikore, siç është Ljubljana, ku gjithnjë krijuesit slllovenë sjellin në trojet e ish-Jugosllavisë ndër të parët refleksionet e artit muzikor modern dhe bashkëkohor. Edhe për Ballatën kjo përbente një përparësi, që e realizoi duke mësuar nga profesorët, që kishin afinitet me një muzikë të tillë, fat ky që shumica e krijuesve tanë nuk e

me një sentencë kishtarë, si misionar i muzikës moderne shqiptare. Krijimtaria e tij nuk veçorizohet vetëm nga pedantizmi i pasiq, por edhe nga një mendim krijues i përparuar e pragmatik, që e mban krijimtarinë muzikore në binarët e normales dhe kësaj ai mishëron një hulumtues e krijues ndër më të suksesshmit, jo vetën të brezit të vet, por edhe më gjërë.

Muzika e shenjtë e Ballatës – shprehje e devocionit

Muzika e shenjtë apo sakrale e Ballatës, për të cilën do të bëjmë

dy personaliteteve të shenja në tri kompozimet për të Madhen Nënë Terezë ("Nënë Tereze bijë Shqiptare - korale, 1990, "Nëna Tereze" - këngë solo, 1990, "Laudi Mater Theresia" - vokalo instrumentale, 1997) dhe në kompozimin vokalo-instrumental "Pro Memoria 1462", sipas Formulës së Pagëzimit të Pal Engjëllit.

Kësaj here, ashtu si në rastin e kompozitorit Vinçenc Gjini, nuk kam pasur vështirësi të shkruaj, por në dallim nga ai, kolegu Ballata, siç e kam thënë, jo vetëm në krijimtari, por edhe në jetë, është

aparati përkatës "Music reader" (kurse vendin e fjalëve e kanë zënë vokalet) dhe kështu kam krijuar një përshkrim rreth tingëllimës së këtyre veprave. Prandaj do t'i shfrytëzoj disa nga shënimet e përmendura duke i shoqëruar, natyrisht, edhe me mendimet e mia për çdo kompozim.

Kompozimin e parë për Nënë Terezë e ka bërë sipas kësaj poezie omonime të Gani Spahiut:

Nënë Tereze bijë Shqiptare

Nënë Tereze bijë Shqiptare, zemërbardhë zemërbujare
Kudo që dielli lëshon rreze, është mirësi e Nënës Tereze
Nënë Tereze bijë Shqiptare, zemërbardhë, zemërbujare
Fjalëmbël, shpirtndritur, për gjithë njerëzit e sflitur
Dorëshpëtim për të varfër, t'pastrehuar, t'pavatër
Nënë Tereze, Nënë Tereze, zemërbardhë që lëshon rreze
Zemërngrohtë, zemërnur, për të mjerë, të sëmur
Nënë Tereze t'i don bota, veprat tua, fjalët e ngrohta
Nënë Tereze, nëna jonë, të roft emri përgjithmonë
Të roftë emri deri n'amshim, bijë e shtrenjtë e popullit tim.

Është kompozuar për për recitues dhe kor trezanor (trezërash) pionierësh ose femrash, e porositur nga Shoqata e kompozitorëve të Kosovës dhe e realizuar (krahsh këngëve të kompozitorëve tanë të tjerë) në koncertin e posaçëm më 1990, me rastin e 80-vjetorit të lindjes së Nënës Tereze. Për të janë dhënë dhe vlerësime kritike. Kënga fillon me recituesen, me vlera të përcaktuara ritmike (Nënë Tereze bijë Shqiptare zemërbardhë, zemërbujare). Vazhdohet me zërat e lartë, të mesëm e të ulët. Në vazhdim e sipër, këta këmbehen me njëri-tjetrin duke i potencuar në vijat e tyre melodike sidomos fjalët domethënëse (Kudo që dielli lëshon rreze, është mirësi e Nënës Tereze/Nëna Tereze bijë Shqiptare, zemërbardhë, zemërbujare/Fjalëmbël shpirtndritur, për gjithë njerëzit e sflitur etj.). Ndërkohë, teksa zërat e mesëm mbajnë një «iso» të gjatë, ndërhyjnë recituesja me fjalët: Nënë Tereze, Nënë Tereze, zemërdritë që lëshon rreze. Pas recitueses, sërish aktivizohen zërat njëri pas tjetrit: zërat e mesëm, të lartë, të ulët (Zemërngrohtë, zemërnur, për të mjerë, të sëmurë/ Nënë Tereze t'i don bota, veprat tua, fjalët e ngrohta/ Nënë Tereze, nëna jonë, të roft emri përgjithmonë/ Të roftë emri deri n'amshim, bijë e shtrenjtë e popullit tim), pas të cilëve – ndërkohë që të gjithë zërat e mbajnë një akord të gëzuar e optimist – përfundon kënga me fjalët e recitueses: Bijë e shtrenjtë e popullit tim. Përgjatë këngës ndeshim vlera të ndryshme ritmike, po ashtu hetohen dhe ndryshime masash metrike (¾, ¾), sikundër – natyrisht – edhe asosh dinamike ("f", "mp", "mf", "ff"). (Vazhdon) (Nëntitujt janë të redaksisë)

“ Muzika e shenjtë apo sakrale e Ballatës, edhe pse nuk është voluminoze, brenda strukturës së saj shquajmë vlera të qëndrueshme të kompozura me pasion e që shprehin kompleksitet përcaktues me devocion, si ndjenjë e pastër, nderim, dashuri e pakufishme ndaj dy personaliteteve të shenja në tri kompozimet për të Madhen Nënë Terezë ("Nënë Tereze bijë Shqiptare - korale, 1990, "Nëna Tereze" - këngë solo, 1990, "Laudi Mater Theresia" - vokalo instrumentale, 1997) dhe në kompozimin vokalo - instrumentale "Pro Memoria 1462", sipas Formulës së Pagëzimit të Pal Engjëllit. ”



Zeqirja Ballata

kanë pasur. Në këto kushte dhe rrethana, falë dhuntisë e talentit, Ballata u pri të krijojë vepra në stil me synime bashkëkohore dhe moderne dhe "të kyçet" me sukses në planetin universal të muzikës bashkëkohore, të cilën edhe na e solli në Kosovë, si ta quajmë:

fjalë më tej në këtë artikull, edhe pse nuk është voluminoze, brenda strukturës së saj shquajmë vlera të qëndrueshme të kompozura me pasion e që shprehin kompleksitet përcaktues me devocion, si ndjenjë e pastër, nderim, dashuri e pakufishme ndaj

të tejet pedant dhe njeri i fjalës, sepse me kërkesën time m'i ka dërguar partiturat me shënime të nevojshme, që ma kanë lehtësuar detyrën që po i ve vetes.

Duhet të theksoj se këto kompozime i kam dëgjuar edhe falë teknikës së sotme digjitale dhe



TA NDIHMOJMË NDËRTIMIN E KATEDRALES

*Jam mik i Kishës Katolike
dhe dua ta ndihmoj
ndërtimin e Katedrales
"Nëna Terezë" në Prishtinë!*

Gjithë juve miq dhe bamirës
të dashur, ju mundësojmë ta
jepni kontributin përmes xhi-
rollogarive bankare.

Faleminderit!

X Raiffeisen BANK
Kosovo J.S.C.
Prishtina, Kosovo
SWIFT code: RBKORS22

Adm. Ap. e Prizrenit
Numri i llogarisë:
EUR: 1501 090000 1990 20
USD: 1501 090000 3765 30
CHF: 1501 090000 3764 33

Valuta	Banka	Shteti	SWIFT/BIC
EUR	Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG	Vienna, Austria	RZBAATWW
USD	American Express Bank, LTD	New York, US	AEIBUS33
CHF	UBS AG	Zurich, CH	UBSWCHZH80A

ABONONI "DRITËN"

Tash mund të jeni abonues të revistës kulturore të Kishës Katolike në Kosovë "Drita". Për vetëm 12 euro në vit (ose 1 euro për secilin numër), ne do t'ju dërgojmë **me postë "Dritën"** (vetëm brenda territorit të Kosovës).

Plotësoni formularin e mëposhtëm, dhe na e dërgoni bashkë me vërtetimin e pagesës në adresën tonë: **Rr. Gjon Pali II 1, 20000 Prizren.**

Emri: _____
Mbiemri: _____
Adresa: _____
Qyteti: _____
Kodi postar: _____
Numri i telefonit: _____
E-mail: _____

Pagesa prej 12 eurosh mund të deponohet në Raiffeisen Bank Kosovo, në llogarinë 1502 0310 0086 0188. Ju lutemi, mos harroni ta futni fletëdeponimin në zarf bashkë me këtë formular. Ju faleminderit!

Për informata më të hollësishme, ju lutemi të na kontaktoni në numrin e telefonit: 029 241 933/14, me faks: 029 241 232 ose me email: revistadrita@hotmail.com ose revistadrita@yahoo.com.



DRITA

"Drita hufon
kundër errësirës
kur ndriçon."
KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Qershor 2008 • Viti XXV • Nr. 6 (165) • Çmimi: Korantë 1€, Kurorë 2€, Zvicër 3€, SHBA \$2.50



PSE KISHA I SHËN PAULIT DHE I NIKOLIT SHENJTERIT?
FIDE 49
(Shkrim: Don Jevon Tisago)

**PAPA PALI VI
PAPA I EKUMENIZMIT, DIALOGUT DHE PAGES**
FIDE 54
(Shkrim: Don Agostino Quaresima)

**LAVONC ANTONI -
PËRITËR I MËDHA
SHËN PAULIT DHE NIKOLIT**
FIDE 60
(Shkrim: Ana Maria Koci)



Viti i Shën Palit - Apostullit të Popujve

SHKRUAR:
Don Fatmir KOLAJE

Me rastin e 2000-vjetorit të lindjes së Shën Palit, në 25 qershor të kësaj viti, Kisha Katolike në Kosovë dhe në tërësi Kisha Katolike në Evropë, festojnë lindjen e kësaj figure të shenjtë të krishterimit. Në këtë numër të revistës "Drita", do të gjeni një përshkrim të detajuar të jetës dhe veprës së kësaj figure të shenjtë. Në këtë numër të revistës "Drita", do të gjeni një përshkrim të detajuar të jetës dhe veprës së kësaj figure të shenjtë. Në këtë numër të revistës "Drita", do të gjeni një përshkrim të detajuar të jetës dhe veprës së kësaj figure të shenjtë.

**Kontributi i klerit katolik
Kongresit të Manastirit**
FIDE 14-15
(Shkrim: Prof. Dr. Jaho DRANÇOLLI)

**Intervista me Arshif Xhaferin
Shqiptarët janë ndër
të parët evropianë
që e pranuan
krishterimin
nga vetë apostujt**
FIDE 16-17

**1. Rëndësia e klerit katolik në
shpirtërishtet e shqiptarëve**
FIDE 18-19